

**Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së
Rahovecit 2018 - 2026
Raporti për Vlerësimin Strategjik Mjedisor
(VSM)**

DRAFT

**Rahovec - KOSOVË
2018**

Lista e shkurtesave

VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
GDP	Prodhimi Bruto Vendor
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Kosovës
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Tabela e shkurtesave

Lista e shkurtesave.....	2
Tabela e shkurtesave	3
1. HYRJE	5
1.1 Te dhënat historike të Komunës së Rahovecit	5
2. LEGJISLACIONI MJEDISOR DHE INSTITUCIONET	6
2.1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 03/L-025)	6
2.2 Ligji për Planifikim Hapësinor (Nr. 03/L-106).....	7
2.3 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis, (Nr. 03/L-214)	8
2.4 Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), (Nr. 03/L-230).....	8
2.5 Ligji për vetëqeverisjen lokale	9
2.6 Konventat Ndërkombëtare Mjedisore	10
2.7 MMPH – Detyrat dhe Përgjegjësit	10
2.8 Vlerësimi i Shpenzimeve të dëmtimit mjedisor	11
3. DIREKTIVAT E BE-s.....	12
3.1 Direktiva e BE-së, VSM	12
3.2 Direktivat e tjera të BE-së.....	12
3.3 Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	13
3.4 Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	13
4. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-se	14
4.1 Metodologjia	14
4.2 Literatura dhe burime e informimt për VSM-n	15
4.3 Konsultimet gjatë VSM-se, me përfaqësues te institucioneve	16
5. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL RAHOVECI 2018-2026.....	17
5.1.1 Pozita gjeografike	17
5.1.2 Organizimi Administrativ dhe qeverisja e Komunës së Rahovecit	18
5.1.3 Numri i popullsisë	18
5.1.4 Vlerësimi i ekonomive lokale dhe familjare	20
5.1.5 Punësimi dhe papunësia	21
5.1.6 Varfëria në Rahovec	21
5.2 ZHVILLIMI SOCIAL	22
5.2.1 Papunësia.....	22
5.3 TRENDËT E SEKTORIT TË EKONOMISË.....	23
5.3.1 Bujqësia dhe shfrytëzimi i tokës	23
5.3.2 Blegtoria.....	24
5.4 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET E TRANSPORTIT	25
5.4.1 Rugë magjistrale M9.1	26
5.4.2 Rugë regjionale	26
5.4.3 Rugë urbane.....	27
5.4.4 Rugë lokale.....	27
5.4.5 Rugë të pa kategorizuara	27
5.5 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË UJËRAVE.....	27
5.5.1 Furnizimi me ujë	27
5.5.2 Infrastruktura dhe shërbimet e furnizimit me energji elektrike	28
5.5.3 Infrastruktura dhe shërbimet e telekomunikacionit.....	28
5.5.4 Menaxhimi i mbeturinave.....	28
5.6 FATKEQËSIT NATYRORE	30
5.6.1 Vërshimet.....	30
5.6.2 Erozioni.....	30
5.6.3 Tërmetet	31
5.7 MJEDISI.....	31
5.7.1 Gjendja e mjedisit	31
5.7.2 Ndotja e ajrit.....	31
5.7.3 Ndotja e ujit.....	32
5.7.4 Ndotja e tokës.....	32
5.7.5 Ndotja akustike	33
5.7.6 Klima.....	33

5.7.7	Hidrografia	33
5.8	RRJETI I SHERBIMEVE	34
5.8.1	Institucionet shëndetësore	34
5.8.2	Institucionet arsimore	34
6.	VSM - VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PZHK-se	34
6.1	Kriteret e zonimit të orientuara nga mbrojtja e mjedisit dhe kohezionit social	35
6.1.1	SWOT analiza gjat hartimit të PZHK	36
7.	PSE ËSHTË I NEVOJSHËM VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR	36
8.	MASAT PËR PARANDALIMIN E DËMTIMIT TË NDIKIMEVE TË MJEDISIT	37
8.1	Reduktimi i ndotjes akustike	37
8.2	Reduktimi i ndotjes së ajrit	37
8.3	Grumbullimi dhe përdorimi i ujit	37
8.4	Ruajtja e Energjisë	38
8.5	Masat për parandalimin ndikimin negative social	38
8.6	Dispozitat në lidhje me bashkëpunimin	38
8.7	Dispozitat mbi rendin kronologjik ose fazat e zbatimit	39
8.8	Elementet dhe udhëzimet për hulumtime të mëtutjeshme	39
8.9	Gjelbërimi	39
8.10	Krijimi dhe sigurimi i hapësirave publike me cilësi të lartë	41
8.11	Një balance mes natyrës dhe traditës	41
9.	PRIORITETET ZHVILLIMORE STRATEGJIKE TE PZHK	41
9.1	Plani zhvillimor komunal Qëllimi dhe Objektivat e PZHK-se	41
9.1.1	Vizioni për të ardhmen e Komunës së Rahovecit, (PZHK Rahovecit 2018-2026)	42
9.1.2	Qëllimet dhe objektivat zhvillimore	43
9.1.3	Koncepti i Zhvillimit Hapësinor	45
9.2	Koncepti i Zhvillimit Hapësinor	45
10.	ZHVILLIMI EKONOMIK SIPAS SEKTORËVE	48
10.1.1	Bujqësia	48
10.1.2	Industria	48
10.1.3	Ndërmarrjet dhe biznesi	48
10.1.4	Potencialet turistike	48
10.1.5	Qasja	48
10.1.6	Pejsazhi	48
10.1.7	Turizmi	48
10.1.8	Zhvillimi social	48
10.1.9	Arsimi	48
10.1.10	Shëndetësia	48
10.1.11	Kultura	48
10.2	Infrastruktura e transportit	48
10.2.1	Transporti publik	48
10.2.2	Infrastruktura teknike	48
10.2.3	Menaxhimi i ujërave	48
10.3	Furnizimi me ujë i qytetit	48
10.4	Menaxhimi i mbeturinave	48
10.5	Furnizimi me energji	48
10.6	Mjedi dhe trashëgimia natyrore	48
11.	ANALIZA E PLOTË E NDIKIMIT NË MJEDIS TË PZHK-SË SIPAS VSM	49
11.1	Masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit	49
12.	MONITORIMI	49
13.	VSM - SUGJERON DISA VEPRIME OPERACIONALE KONKRETE	49
14.	PËRFUNDIME	49
15.	REFERENCE- LITERATURA	49

1. HYRJJE

Raporti i vlerësimit strategjik të mjedisor (VSM) është përgatitur si dokument përfundimtar i procesit të VSM-se, për planin zhvillimor komunal të Komunës së Rahovecit.

VSM është në përputhje me ligjin për VSM Nr. 03/L-230, i cili është transpozim (Përputhshmëri) i direktivës së BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedisit.

Vlerësimi strategjik mjedisor është një obligim ligjor por edhe funksional në të cilin analizohen ndikimet në mjedis në fushën e shfrytëzimit të tokës, bujqësisë, pylltarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit të mbeturinave, menaxhimit të ujërave, telekomunikacionit, turizmit dhe fushave tjera.

Metodologjia për hartimin e raportit të VSM–se është në përputhje me ligjin për VSM VSM përfshin pikat e mëposhtme:

- a) Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor.
- b) Përshkrim të Vizionit, të prioritetit dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të.
- c) Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritshëm të tij në rast se nuk zbatohet plani .
- d) Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka mundësi të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani.
- e) Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin.
- f) Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektivat janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- g) Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- h) Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
- i) Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- j) Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

1.1 Te dhënat historike të Komunës së Rahovecit

Pas përfundimit të Luftës në qershor të vitit 1999 Kosova ka hyr nën administrimin ndërkombëtar të Kombëve të Bashkuara. UNMIK-u shtriu ndikimin e vet edhe në qeverisjen lokale, ku sipas Nenit 3 të rregullores së vet Nr. 2000/45, komunave ju ndanë rolet dhe përgjegjësit, si dhe rolin në ofrimin e kushteve themelore bazike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Procesi i decentralizimit në Kosovë qartësojë edhe kompetencat për vetëqeverisje lokale. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 në Kreu III Kompetencat komunale, Neni 15 Parimi i subsidiaritetit – Komunitet ushtrojnë

kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit dhe, Neni 16 –Komuna ushtron kompetenca vetjake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin. Organet komunale janë: Kuvendi që është organi më i lartë në komunë dhe, Kryetari që kryen udhëheqjen komunale të ekzekutivit.

2. LEGJISLACIONI MJEDISOR DHE INSTITUCIONET

2.1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 03/L-025)

Ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky ligj ka për qëllim:

- shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e vlerave të emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar;
- përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;
- ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtitshme dhe të papërtitshme, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre;
- bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
- bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit;
- të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, ajri, uji dhe burimet e jetesës në Kosovë të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme;
- të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit; dhe
- të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Parimet kryesore, të cilat rregullojnë legjislacionin mjedisor në Kosovë, janë të përafërta me ato të Bashkimit Evropian.

- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i përafrimit të integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit
- Ndotësi paguan;
- Ndërgjegjësimi publikut dhe pjesëmarrja në vendim marrje

Lidhur me Planet Zhvillimore Komunale, Urbane dhe Planet Rregulluese Urbane duke ju referuar dhe Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, kërkohet që në hartimin e planeve të merret parasysh ndjeshmëria e mjedisit, kapaciteti bartës i saj, lidhja dhe harmonia e vlerave të peizazhit natyror, lidhja ndërmjet burimeve natyrore të përtitshme dhe të papërtitshme, trashëgimia kulturore, si dhe tërësia e ndërveprimeve ndërmjet zhvillimeve ekzistuese në mjedis

dhe atyre të planifikuara, ku behet fjale ekskluzivisht për VSM, theksohet ndër të tjera se këtij vlerësimi i nënshtrohen projektet e planifikimit të territorit, si dhe planet e programet e zhvillimit kombëtar, rajonal e vendor.

Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit, është përgjithësisht në përfaqësim me direktivat dhe standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Të cilat direktiva kërkojnë:

- Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.;
- Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.;
- Për menaxhimin e integruar të mbeturinave;
- Për mbrojtjen e biodiversitetit.;
- Për trajtimin e ujërave të ndotur.;
- Për substancat dhe preparatet kimike.;
- Për administrimin e zhurmave në mjedis.;
- Për zonat e mbrojtura.;

2.2 Ligji për Planifikim Hapësinor (Nr. 03/L-106)

Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji nr.03/L-106, si qëllim kryesor i këtij ligji është rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban. Sipas këtij akti ligjor, planifikimi hapësinor duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të Kosovës dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm, po ashtu duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet. Në mesin e parimeve është po ashtu edhe përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur.

Parashikohet që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke themeluar Komisionin e Ekspertëve të Planifikimit (në nivelin lokal) dhe Këshillin për Planifikim Hapësinor (në nivel kombëtar). Në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Posaçme, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Planet për Zhvillim Urban, Planet Rregulluese Urbane. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 5 vjetëve dhe ta përfshijë një plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Po ashtu duhet ta përfshijë një përmbledhje të shkurtër të ndikimeve shoqëro-ekonomike dhe mjedisore. Raporti i VSM, identifikon që institucioni kryesor që është përgjegjës për zbatimin e ligjit të sipërpërmendur në nivel kombëtar është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) e cila në pajtim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor. MMPH është po ashtu përgjegjëse për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin. Në kuadër të sistemit të Kosovës të planifikimit në dy nivele, niveli i qeverisjes lokale ka rol të rëndësishëm në zbatimin e parimeve dhe të kërkesave planifikuese të përcaktuara nga Ligji për Planifikimin Hapësinor. Komunitetet e Kosovës luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e komuniteteve të tyre, duke krijuar pasuri dhe duke imponuar identitetin lokal. Shoqëria duhet të ketë udhëheqje të fuqishme që i bashkon të gjitha palët e interesuar relevante, përfaqësuesit e komunitetit dhe të

biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin e strategjisë duke u bazuar në një vizion të përgjithshëm. Ky është njëri nga aktivitetet kryesore që pritet ta kryejnë komunat.

—Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.;

—Për taksën e karbonit e të ambalazhit plastik.;

Krahas hartimit të ligjeve, vitet e fundit, është punuar për plotësimin me akte nënligjore të ligjeve të miratuar, me qëllim që të lehtësohet zbatimi praktik i tyre: Drejtim tjetër të rendesishëm në plotësimin e kuadrit ligjor, kanë përbërë hartimi dhe miratimi i një sere rregulloresh dhe udhëzimesh të karakterit organizativ apo teknik dhe që synojnë mirë funksionimin e institucioneve përkatëse dhe bashkërendimin institucional të veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit. Hartimi dhe miratimi i këtyre akteve, zgjeron dhe forcon bazën ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

2.3 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, (Nr. 03/L-214)

Ky ligj ka për qëllim parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Ky ligj gjithashtu përcakton rregullimin e procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor, dhe siguron që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin janë ofruar dhe janë marrë parasysh. (Neni 1) Fushëveprimi i këtij ligji janë Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis - VNM, identifikimi, përshkruarja dhe vlerësimi në mënyrë të duhur i rrethanave të secilit rast individual, efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndonjë projekti në:

- Njeriun, botën bimore dhe shtazore;
- Tokë, ujë, ajër, klimë dhe peizazh;
- Të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore;
- Ndikimet e ndërsjella të elementeve të cekura më lartë. (Neni 3)

Ligji i VNM është një nga aktet ligjore me të rendesishëm për parandalimin e ndotjes apo dëmtimit të mjedisit nga aktivitetet humane. Ky ligj kërkon bërjen e një vlerësimi të përgjithshëm, të integruar dhe në kohe të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis.

2.4 Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), (Nr. 03/L-230)

Qëllimi i këtij ligji është që: Me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ky ligj gjithashtu përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, (në tekstin e mëtutjeshëm VSM) përmes integritetit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

(Neni 1) Fushëveprimi

- VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis.
- Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit e mbeturinave, menaxhimit e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat, duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.
- Për planet dhe programet nga paragrafi 1. i këtij neni, me të cilat parashihet edhe shfrytëzimi i sipërfaqeve të vogla në nivel lokal ose në rastet e modifikimeve të vogla të planeve ose programeve, të cilat nuk kërkojnë procedurë të rregullt për miratim si dhe për planet ose programet të cilat nuk janë të cekura në paragrafin 2. të këtij neni, vendimin për VSM e merr autoriteti përgjegjës i planit ose programit, nëse sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj, vërteton se ekziston mundësia e ndikimit të theksuar në mjedis.

VSM nuk bëhet për planet dhe programet të cilat i dedikohen mbrojtjes së vendit, evitimit të pasojave nga katastrofat natyrore dhe për planet financiare dhe buxhetore.(Neni 3)

2.5 Ligji për vetëqeverisjen lokale

Ky ligj (Ligji Nr. 03/L-040) themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. E drejta për :

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal; janë kompetencat vetanake, të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, këto kompetenca janë përcaktuar me nenin 17 të ligjit për vetëqeverisjen lokale. Në fakt hartimi i VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës duhet merrë në konsideratë edhe ligjet tjera që kanë ndikim ose rregullojnë fushat e ndryshme të mbuluara nga Plani Zhvillimor Komunal siç janë:

Ligjin për mbrojtjen e natyrës (Ligji nr. 03/L-233)

Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (Ligji nr. 03/L-160)

Për mbrojtjen nga zhurma (Ligji nr. 02/L-102)

Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Ligji nr. 04/L-027)

Për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare (ligji nr. 03/L-104)

Ligji për ujërat e Kosovës

Ligji për mbeturina (2011/04-L-060)

Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural (2009/03-L-98)

Ligji për Pesticidet2003/20

Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës(2004/29)
Ligji për Rrugët (2003/11)
Ligji për tokat bujqësore (2005/02-L26)
Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura(2008/03-L039)
Edhe disa ligje të tjera:

2.6 Konventat Ndërkombëtare Mjedisore

Ne kontekstin e këtij raporti, disa nga konventat mjedisore të cilat duhet marrë parasysh gjatë hartimit të VMS janë renditur me poshtë.

Konventa e Bernës; Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës.

Konventa e Bazelit; Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre..

Konventa e Vjenës; Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit. dhe Protokolli i Montrealit Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit.

Konventa e Aarhus-it; Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendim-marrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit..

Konventa e Espoo-s Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar.

Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara Për ndryshimet klimatike,

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin,

Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër të mjedisit natyror të Europës

Konventa për mbrojtjen e specieve shtegtuuese të kafshëve të egra

Konventa për ndotjen atmosferike në distanca të mëdha

Konventa për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar

Konventa për rivlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar

Konventa e Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare

Konventa e mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre,

Konventa e Stokholmit; Mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm,

2.7 MMPH – Detyrat dhe Përgjegjësit

MMPH-ja është përgjegjëse për menaxhimin e çështjeve të përgjithshme në fushat e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Me saktësisht MMPH-ja ka për obligim zhvillimin e politikave, normave dhe standardëve si dhe koordinimin e aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit, menaxhimin e ujërave, inspektimin mjedisor dhe planifikimin hapësinor. Gjithashtu është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe legjislacionit që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimit hapësinor.

MMPH-ja harton politika në këto fusha:

Mbrojtja e mjedisit;

Administrimi i integruar i ujërave;

Zbatimi i ligjit për ndërtim dhe hartimi i strategjisë për fushën e ndërtimit modern;

Rregullimi i fushës së Banimi dhe krijimi i politikave të zhvillimit të qëndrueshëm;

Efikasiteti dhe modernizimi i sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit;

Veprimi operativ i inspektoratit për zbatimin e ligjit për inspektim të mjedisit;

Menaxhimi efikas i mbeturinave;

Hartimi i planit hapësinor të Kosovës;

Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore;

Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi aktiv në iniciativat Evropiane dhe ndërkombëtare për sektorin e mjedisit;

Bazuar në faktin se gjendja e mjedisit në Kosovë është larg standardëve mjedisore të Bashkimit Evropian, gjendje kjo e krijuar si rrjedhojë e zhvillimeve të paplanifikuara, mungesës së planit hapësinor, menaxhimin e dobët të mbeturinave industriale dhe shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i resurseve natyrore që ka rezultuar në degradimin e mjedisit deri në përmasa shqetësuese, përfshirë këtu edhe zvogëlimin e bidoiversitetit.

E gjithë kjo që u theksua tregon se përmirësimi i gjendjes në mjedis dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mjedisin janë sfida të cilat kërkojnë zgjidhje në mënyrë që të behët e mundur, në radhë të parë ngritja e kualitetit të jetës së qytetarëve por edhe avancimi, harmonizimi dhe integrimi i standardeve kombëtare mjedisore me standardet e Bashkimit Evropian.

MMPH-ja synim ka këto objektiva :

Përmirësimi i gjendjes në mjedis ;

Menaxhimi resurseve ujore ;

Planifikimi Hapësinor , Ndërtimi dhe Banimi ;

Fuqizimi i Inspektoratit

2.8 Vlerësimi i Shpenzimeve të dëmtimit mjedisor

Një analizë gjithëpërfshirëse dhe e azhurnuar e përgatitur nga Banka Botërore është prezantuar në qershor 2012. Objektivi i kësaj analize është të raportojë lidhur me gjendjen e mjedisit dhe çështjet kryesore mjedisore dhe ta vlerësojë koston shëndetësore dhe ekonomike të këtyre çështjeve. Kostot maten si për shembull ndikimet në shëndet (sëmundjet dhe vdekshmëria e hershme) dhe pastaj shprehen si kosto vjetore të dëmit ekonomik në euro dhe si pjesë e bruto prodhimit vendor (GDP). Duke i caktuar vlera monetare të degradimit të mjedisit, analiza (Banka Botërore, 2012) këtu arrin katër rezultate kryesore: `siguron një mekanizëm të dobishëm për renditjen e shpenzimeve relative sociale të formave të ndryshme të degradimit dhe ofron një mjet për dhënien prioritet problemeve të mjedisit. Ai ju ofron krijuesve të politikave një instrument për integrimin e mjedisit në vendimmarrjen ekonomike. Ai shpreh shpenzimet e dëmeve si pjesë e GDP, duke e mundur krahasimin me indikatorët e tjerë ekonomikë`. Ju ofron aktorëve të ndryshëm një mjet për diskutimin e rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit në aspektin ekonomik – të dobishme për të vendosur lidhur me mënyrën e ndarjes së burimeve të pakta dhe për ta ngritur vetëdijen e —çmimit të të bërit asgjëll lidhur me problemet urgjente të mjedisit.

Sipas raportit (Banka Botërore, 2012) kostoja vjetore e degradimit të mjedisit në Kosovë vlerësohet të jetë 123 milionë €– 323 milionë € më 2010, me një vlerësim mesatar prej 221 milionë €. Kjo kosto është e barasvlershme me 2.9–7.7 për qind të GDP, me një mesatare prej 5.3 për qind. Kostot janë tregues dhe jo shifra të sakta, meqë ka mungesa të mëdha të të dhënave, disa të dhëna nuk janë azhurnuar së fundi – për shkak të historisë së trazuar të vendit – dhe nuk mund të jepen shifra në para të të gjitha ndikimeve. Me kostot vjetore prej 221 milionë € të degradimit të mjedisit, Kosova ballafaqohet me ndikime serioze shoqërore dhe ekonomike për shkak të aktiviteteve të menaxhuara dobët dhe do të mund të arrinte përfitime të mëdha nga veprimet riparuese për mbrojtjen dhe ruajtjen e cilësisë së mjedisit. Kostoja e ndotjes së jashtme të ajrit në zonat urbane, ku ndikimet më domethënëse të cilat i shkaktohen shëndetit vlerësohen të jenë çështje mjedisore me ndikimin më të madh – kostot e vlerësuara të dëmit sillen prej 37 milionë euro në 158 milionë euro në vit (0.89-3.76 për qind e GDP). Vlerësohet se ndotja e ajrit shkakton 835 të

vdekjeve të parakohshme, 310 raste të reja të bronkitit kronik, 600 pranime në spital dhe 11,600 vizita urgjente çdo vit. Çështje të tjera të rëndësishme mjedisore në Kosovë të cilat janë analizuar dhe vlerësuar më tepër në Kosovë në kuadër të shqyrtimit janë cilësia e ujit, mbeturinat e ngurta, burimet e pyjeve/të tokës dhe minierat/energji e prodhimit

3. DIREKTIVAT E BE-s

3.1 Direktiva e BE-së, VSM

Direktiva e Këshillit 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis (Direktiva VSM) u aprovua më 27.06.2001. Direktiva VSM vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Direktiva VSM nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian ..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legjislative, rregulluese ose administrative. Një VSM është i obligueshëm për planet/programet të cilat janë të shënuara në Direktivë si vijon: përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzim të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM); janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës. Procedura VSM mund të përmbledhet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativat e arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e paparashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

3.2 Direktivat e tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore dhe të qëndrueshmërisë. Sipas Marsden (2008) VSM ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti meqë vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për

paraqitjen e planeve (dhe të programeve) por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

3.3 Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit —Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Objektivi i Konventës Me qëllim që të kontribuojmë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotme të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, çdo Palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të patur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNECE mbi Qasjen ..., 1998) 'Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartojnë dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon: të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë; të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave joqeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim; të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.'

3.4 Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi Mjedisor, 1991) përcakton 'obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit'. Po ashtu i formulon 'obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve'. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997.

Siç thekson Marsden (2008), 'Protokollin e Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008)'. Protokollin është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse

në Konventën Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi strategjik i mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokolli po ashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokolli kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillim rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

4. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-se

4.1 Metodologjia

Kryerja e VSM për programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor. Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Rahovecit, është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore.

Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për menjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme nga zhvillimi i Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis dhe ligjin për VSM, i cili është transpozimi i direktivës së BE.

VSM do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- Përmbledhja e elementeve të planit në vlerësim e sipër, PZHK-ja e Rahovecit , si bazë për vlerësimin mjedisor;
- Përshkrim të Vizionit, priritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritshëm të tij në rast se nuk zbatohet plani ;
- Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose
- Ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat
- Natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;

- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
- Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.
- Plani Zhvillimor Komunal për numrin e madh dhe diversitetin e gjere te problematikes qe trajton, kërkon konsultimin e një game te konsiderueshme dokumentacioni. Behet fjale për plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektorë te ndryshëm ekonomik dhe social.

Ky dokumentacion përveç materialeve qe dispononte vete Grup hartues i VSM-s, u sigurua nga komuna e Rahovecit në bshkëpunim me MMPH dhe institucione dhe organizata te shoqerise civile tjera. Me poshtë po rendisim disa nga dokumetat kryesore qe u përdoren ne trajtimin e aspekteve te ndryshme mjedisore për komunën e Rahovecit dhe me gjere.

4.2 Literatura dhe burime e informimt për VSM-n

Materiali që përben detyrën e projektimit, sqaruar në dokument si Plani Zhvillimor i hartuar nga grupet punuese, trajton ne mënyre serioze problemet mjedisore te komunës së Rahovecit.

Ky dokument nder te tjera përmban informacion lidhur me shtrirjen gjeografike, gjeologjinë, sizmiken, hidrologjinë, hidrografinë, mbetjet e natyrave te ndryshme, cilësinë e ajrit, ndotjen e burimeve ujore, ekonominë, infrastrukturën, transportin, urbanistiken, informacion mbi sektorët socio-ekonomik. Ne përgjithësi materiali është i kompletuar, në veçanti në trajtimin e problemeve mjedisore me te cilat përballet komuna.

Ai përmban të dhëna analitike mbi mjedisin fizik, mbetjet, cilësinë e ajrit dhe te ujërave sipërfaqësore, etj.

Plani hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në mjedis kanë përcaktuar vizionin për mjedisin i cili përkufizohet si: zhvillimi i qëndrueshëm i vendit duke mbrojtur pasuritë natyrore nga ndotja dhe dëmtimi dhe promovimi i vlerave mjedisore.

Për realizimin e këtyre perspektivave, investimet për mbrojtjen e mjedisit me qellim qe standardet e Bashkimit Evropian te mund te arrihen brenda viteve te ardhshëm do te fokusohen ne fushat e mëposhtme:

- Trajtimi i ujërave te ndotura;
- Menaxhimi i mbetjeve te ngurta dhe ndërtimi i vend-depozitimeve sipas standardeve te BE;
- Mbyllja ne zonat e ndryshme e vend-depozitimeve ekzistuese;
- Rehabilitimi i tokave te ndotura dhe burimeve te ndotjes;
- Përmirësime teknologjike ne objektet industriale

Drejtimit e mësipërme për rehabilitimin dhe mbrojtjen e mjedisit, janë probleme prioritare për komunën e Rahovecit. Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit paraqet një plan të hapësirës së Rahovecit për vitin 2018-2026. Ai nënvizon gjithashtu edhe nevojën për të adresuar boshllëqet financiare, njerëzore e të burimeve institucionale për një ekzekutim efektiv të planit.

Mbi bazën e programit te Qeverise për mbrojtjen e mjedisit, ajo përcakton edhe qëllimet të cilat në mënyre të përmbledhur janë:

- Përmbushja e standardeve të kërkuara (BE, Organizata Botërore e Shendetesise - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbeturinat urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës;
- Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese apo substanca të cilat shkatërrojnë shtresën e ozonit, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;
- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona evropiane dhe ndërkombëtare;
- Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe;
- Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve.

Pothuajse të gjitha keto probleme mjedisore për të cilat Plani ka përcaktuar synimet, janë problem me të cilat ndeshet edhe komuna e Rahovecit. Zbutja dhe zgjidhja e tyre përben një kontribut madhor në realizimin e këtij Plani.

Për një vlerësim sa më real të situatës mjedisore në komunën e Rahovecit dhe luhatjen e saj në vite, krahas të dhënave për problematiken mjedisore të Komunës të nxjerra nga Detyra e Projektimit (Plani Zhvillimor Komunal), informacione më të gjëra dhe sistematike të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, zhurmave, menaxhimit të mbetjeve, etj, u gjeten në Raportet Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenta tjera të nivelit qendrorë, përgatitur institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

4.3 Konsultimet gjatë VSM-se, me përfaqësues të institucioneve

Autoret e raportit të VSM-se për PZHK-se të Rahovecit janë përfshirë në konsultime në shumë takime dhe mbledhje me përfaqësues me institucione të ndryshme në kuadër të vlerësimit strategjik të PZHK-së.

Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve profesionale të qeverisjes komunale dhe qendrore, si edhe botes akademike dhe eksperte të pavarur kanë zhvilluar një numer të konsideruar të mbledhjeve deri në finalizimin e PZHK-së, që nga fillimi deri tek debatet mbi zgjidhjet hapësinore apo infrastrukturore.

Autoret e VSM, kanë marrë për bazë rrugën zhvillimore të PZHK-se, duke u bazuar në shënimet zyrtare të këtyre mbledhjeve si dhe shqyrtimin e plotë të materialit të PZHK-se, nga autoret në kuadër të përgatitjes së raportit të VSM.

Në mënyrë të ngjashme, Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve të qeverisjes komunale dhe qendrore, me përfaqësues edhe të shoqërisë civile dhe sektorit privat gjatë disa takimeve kanë debatuar për vizionin e zhvillimit të komunës në nivel me të gjere. Edhe shënimet e këtyre takimeve janë shqyrtuar nga autoret e raportit të VSM-se.

Nga proces-verbalet e mbledhjeve dhe takimet me anëtare të Grupeve punuese të komunës së Rahovecit, si edhe me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

pranë kësaj komune, janë marre informacione dhe të dhëna të ndryshme që lidhen me shtrirjen e komunës (gjeografia), projeksione të popullsisë në zonë të ndryshme të komunës, zonimin, peizazhin, infrastrukturën rrugore, zonat rekreative, zonat e ndotura, menaxhimin e mbetjeve, infrastruktura e ujit të pijshëm, ujërave të zeza dhe të bardha, zonat e parkimit. Këto informacione dhe takime kanë ndihmuar grupin e hartimit të VSM-s, të fokusohet me mirë në zonë ekzistuese të Komunës dhe sipërfaqe që mendohet të shtohen, ku parashikohen zhvillime të caktuara.

Gjithashtu takime janë realizuar me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur problematiken mjedisore në komunën e Rahovecit zonat e ndotura mjedisore (hot spote) dhe zonat me rendësi ekologjike. Këto takime kanë ndihmuar autorët veçanërisht në hartimin e kriterëve kufizues mjedisore


5. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL RAHOVECIT 2018-2026, Gjendja Ekzistuese

5.1.1 Pozita gjeografike

Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.89 km², që shtrihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në V-L me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në J-L me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km.

Ekziston lidhje të mira komunikative në mes komunave dhe në Lindje të komunës kalon magjistralja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren –Pejë.

Territori i komunës shtrihet në hemisferën në mesë shkallës 420 e 30’ dhe 420 e 50’ të gjerësia gjeografike veriore dhe ndërmjet 200 e 21’ dhe 200 e 55’ të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krusha e Madhe deri në 920 m. lartësi mbidetare Zatriqi




Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshorë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lugina ose rrafshina janë këto: (310 – 350 m.)

Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m. që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçisht, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Baboc, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave.)

Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1.000 m. e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoc.



5.1.2 Organizimi Administrativ dhe qeverisja e Komunës së Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej 275.89 km², në të cilin territor shtrihen 34 fshatra me 2 vendbanime dhe me vetëm një qendër urbane.

Territori i komunës së Rahovecit ndahet në 34 zona kadastrale, dhe të gjitha vendbanimet (fshatrat) janë me nga një zonë kadastrale, me përjashtim të 3 zonave: Retije që në vete përfshinë dy vendbanime (Reji dhe Retijë e ulët), zona kadastrale Çifllak që përfshinë edhe vendbanimin e Saroshit si dhe zona kadastrale Denjë që në vete përfshinë edhe vendbanimin e Babocit.

5.1.3 Numri i popullsisë

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka gjithsej 56.208 banorë. Shtrirja e popullatës në komunë është më shumë në zonë rurale sesa

urbane, me 15.892 banorë në zonën urbane (28.7%) dhe 40.316 (71.3%) në zonat rurale.

Në bazë të vlerësimeve të bëra, në Komunën e Rahovecit dominon mosha e re, dhe atë si në zonën urbane njashtu dhe atë rurale. Ndërsa grupmosha dominante e popullsisë janë kategoria 19-44 vjeçe.

Nëse bëhet një analizë më e thellë e strukturës së popullsisë në komunën e Rahovecit mund të vërehet se popullsia është e shtrirë po thuajse në mënyrë të barabartë në të gjitha zonat. Mund të shifet një numër më i madh i shtrirjes së banorëve (71.6%) në pjesën rurale të Komunës gjegjësisht në distancat nga 3-9 km.

Në vitin 1948 Rahoveci kishte 20287 banorë, ndërsa të dhenat e fundit tregojnë se numri i banorëve në Komunë sillet rreth 56208 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (62 vjeçare) numri i popullsisë është rritur për më shumë se tri herë.

Sipas të dhënave vërehet se deri në vitet e 60-ta komuna e Rahovecit ka shënuar rritje demografike, por shkallët e kësaj rritje kanë qenë më e vogla nga fakti se kishte shkallë të larta të natalitetit dhe mortalitetit ku si pasojë kishte shtim të ulët natyror.

Pas viteve të 60-ta gjegjësisht viteve të 70-ta kemi një rritje më të theksuar të popullsisë si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe në anën tjetër shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë ku si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtimit natyror.

Popullsia e komunës së Rahovecit jeton në gjithsej 37 vendbanime, prej tyre 36 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15892 banorë që do të thotë se rreth 29 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40316 banor apo rreth 71 %.

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të komunës së Rahovecit kanë më tepër se 1000 banorë. Numër më të madh të popullsisë ka vetë qyteti i Rahovecit (15892 b). Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Krushë e Madhe (4473 b), Ratkoc (3791 b), Xërxë (3184 b), Radost (2346 b), Bellacerka (2270 b), Opterush (1911 b). Ndërsa vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë janë: Bërnjak (40 b), Kaznik (164 b), Mrasor (191 b), Nashpall (220 b).

Dendësia e popullsisë në komunën e Rahovecit është rreth 204 banorë në 1 km², ku rreth 56208 banorë jetojnë në 275.9 km².

Brenda territorit të komunës së Rahovecit ekzistojnë dallime për sa i përket dendësisë së popullsisë. Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Kjo është në raport edhe me hapësirën e vendbanimit, ku disa vendbanime që kanë hapësirë më të vogël (zona kadastrale e vendbanimit është e vogël), dendësia e popullsisë është më e madhe.

Dendësia më e lartë e popullsisë paraqitet në vendbanimin Krushë e Madhe me 447 banorë në km², kjo për shkak se ky vendbanim ka një sipërfaqe prej 10 km².

Vendbanimet tjera me dendësi po aq të madhe janë Nushpall ku mesatarisht jetojnë rreth 344 banorë në një km², Rahoveci me 328 b/km², Celina me 333 b/km² etj.

Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Sarosh (1 b/km²), Hoqa e Madhe (9 b/km²), Bërnjak (9 b/km²).

Shtimi natyror i popullsisë së Komunës së Rahovecit është se në tërë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte faktor primar i rritjes së përgjithshme të numrit të popullsisë. Në periudhën e pasluftës, krahas shkallës së lartë të natalitetit, edhe mortaliteti ishte mjaft i lartë për shkak të mortalitetit të lartë infantil, si rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit social e mjekësor.

Gjatë periudhës 1971 – 1981, krahas rënies së natalitetit, bie dukshëm edhe mortaliteti e me këtë zvogëlohet edhe shtimi natyror i popullsisë.

Gjatë vitit 2009 në komunën e Rahovecit janë shënuar 1255 lindje dhe 205 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje për komunën e Rahovecit.

Shkalla e natalitetit në komunën e Rahovecit është 17.5 promil apo 1.75 %. Shkalla e mortalitetit është 2.3 promil apo 0.29 %. Në bazë të këtyre shkallevë të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 14.6 promilë apo 1.46 %.

Struktura e popullsisë është e lidhur ngushtë me lëvizjen natyrore dhe mekanike të popullsisë. Kjo strukturë mund të shqyrtohet nga aspekti biologjik, ekonomik, social, nacional, fetar etj.

Komuna e Rahovecit në aspektin e zhvillimit demografik ka veçorit e sajë edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktor demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Rahovecit ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar të piramidës sipas moshës, edhe pse periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja.

Të dhënat për grup-moshën janë marr nga vlerësimi i komunës për vitin 2003 dhe gjithashtu janë analizuar edhe numri i lindjeve në periudhën e fundit ku vërehet një rënie e tyre në krahasim me vitet e më parshme. Forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e sajë dhe kjo si pasojë dy faktorëve: migrimeve dhe të tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 4 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup- moshën 5 deri 9 vjeç dhe 10 deri 14 vjeç.

Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.

Mbi 40 % të popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç, ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël me 8.8 % të popullsisë së përgjithshme.

Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Rahovecit ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1051, që do të thotë se mesatarisht ekzistojë 1051 meshkuj në çdo 1000 femra.

Struktura etnike e popullsisë në komunën e Rahovecit ka një ka një popullsi mjaft homogjene ku mbi 95 % e popullsisë janë shqiptar.

Sipas vlerësimit, që është realizuar nga Komuna e Rahovecit, popullsia shqiptare dominon me 96.68 % ndërsa etnitetet tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël, Serbet me 2.72 % dhe Romët me 0.5 %.

5.1.4 Vlerësimi i ekonomive lokale dhe familjare

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomikë, social, demografik etj.

Siç dihet, ekzistojnë dallime sipas komunave në Kosovë sa i përket madhësisë së familjes. Komuna e Rahovecit kryesisht karakterizohet me numër të madh të

anëtareve të familjes, që është karakteristikë për vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale.

Në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve për numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare në komunën e Rahovecit, del se mesatarja e madhësisë së familjes është 7.7 anëtar.

Ekonomi familjare me 1 - 3 anëtar ka mjaft pak dhe kjo është një dëshmi se, me gjithë transformimet socio-ekonomike dhe të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë në komunën e Rahovecit nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes shthurjes së ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara.

5.1.5 Punësimi dhe papunësia

Papunësia është një ndër problemet me të cilën më së shumti po përballlet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat (58.06%), pavarësisht nga shkalla shumë e lartë e jo aktivitetit për ato. Edhe pse, nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e papunësisë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë. 1

2 Në komunën e Rahovecit veprojnë 1000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare. Problemi i nivelit të lartë të papunësisë në nivel të Kosovës, reflektohet edhe në Komunën e Rahovecit. Te punësuar në subjektet ekonomike janë 3.501 apo në 1.000 banorë të afte për punë rreth 110 të punësuar në ekonomi.

5.1.6 Varfëria në Rahovec

E shkaktuar nga një mori faktorësh, varfëria është e përhapur gjerësisht në Kosovë. Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se mbi gjysma e popullsisë (50.3%) jetojnë në varfëri të përgjithshme, ndërsa rreth 13% e popullsisë jeton në varfëri ekstreme.

Largimet e dhunshme nga puna të popullsisë shqiptare nga pushtuesi serb, në fillim të viteve të '90-ta, shkallë e ulët e arsimit, zhvillim i pa balancuar ekonomik, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve nga lufta e fundit në Kosovë ('99), etj. ndikuan drejtpërdrejt në shkallën e lartë të varfërisë. Varfëria ka prekur të gjitha komunat e Kosovës ku më pak e ku më shumë është e theksuar.

Sipas hulumtimeve të bëra nga organizata të ndryshme përkatësisht UNDP-së, shkalla e përgjithshme e varfërisë në komunën e Rahovecit është 73.54 %. kemi këtë paraqitje të varfërisë;



Sipas hulumtimit të lartpërmendur 12.35% e popullsisë së kësaj komune jetojnë me një dollar në ditë për person, 69.57% e popullatës jeton me dy dollar në ditë për person, në varfëri ekstreme jetojnë 10.86% e popullsisë dhe me varfëri të përgjithshme jetojnë 72.20% e popullsisë.

Ndërsa, pas grumbullimit të dhënave nga Qendra për Punë Sociale për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra na paraqitet shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, na ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës.

Sipas të dhënave del se në komunën e Rahovecit ekzistojnë 2581 persona apo 590 familje që jetojnë me asistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varfëri ekstreme. Ndërkaq, varfëria e përgjithshme përfshinë një përqindje më të madhe të popullsisë.

Me shkallë më të lartë të varfërisë është e prekur gjinia mashkullore me 75%, kurse me asistencë sociale 25% janë kryefamiljare nëna. Kjo shkallë e lartë e varfërisë është e shtrirë gjerësisht në tërë territorin.

Vendbanimet që kanë përqindje më të vogël të popullsisë me asistencë sociale janë: Bellacerka, Nashpalli, Radosti, Sapniqi, Zoqishta, Palluzha, Krusha e Madhe, Kramoviku, Brestovci dhe Bratotini. Ndërsa vendbanimet me përqindje më të madhe të popullsisë me asistencë sociale janë: Kazniku, Senoci, Zatriqi, Petkoviqi dhe Dabidoli.

5.2 ZHVILLIMI SOCIAL

5.2.1 Papunësia

Papunësia është një ndër problemet me të cilën më së shumti po përballlet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat (58.06%), pavarësisht nga shkalla shumë e lartë e jo aktivitetit për ato. Edhe pse, nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e papunësisë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë.

Ne komunën e Rahovecit veprojnë 1000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, sherbyese dhe tregtare. Problemi i nivelit të lartë të papunësisë në nivel të Kosovës, reflektohet edhe në Komunën e Rahovecit. Te punësuar në subjektet ekonomike janë 3.501 apo në 1.000 banorë të afte për punë rreth 110 të punësuar në ekonomi.

5.3 TRENDËT E SEKTORIT TË EKONOMISË

5.3.1 Bujqësia dhe shfrytëzimi i tokës

Zhvillimi i sektorit të Bujqësisë në komunë kishte një kalim të popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore ku kjo vazhdimisht rritej, gjë që është ligjësi e përgjithshme në kuadër të zhvillimit

ekonomik. Transferi i popullsisë nga bujqësia dhe të shumtën e fshatit në veprimtari jobujqësore dhe në qytet zhvillohej në mënyrë të drejtperdrejtë, pa përgatitje profesionale dhe arsimore, në një anë, dhe në mënyrë indirekte, përmes shkollimit të gjeneratës së re dhe të ndryshimit të pozitës socio-ekonomike të popullsisë, në anentjetër.

Është karakteristik e përgjithshme se bujqësinë e braktis popullsia e re, vitale dhe e arsimuar. Por është e vështirë të konstatohet numri i saktë i kalimit të popullsisë agrare në veprimtari joagrarë.

Ndryshimet në strukturën profesionale dhe në atë të moshave të popullsisë ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë së afte për punë, që paraqet oferten disponuese të fuqisë punuese.


Numri i popullsisë aktive është 32.000 e prej tyre 16.744 janë meshkuj dhe 16.304 femra. Në këto kushte të pamjaftueshme në zhvillimin ekonomik ndikon në rritjen e fuqisë së afte punuese duke shkaktuar vështirësi të shfrytëzimit racional të fuqisë aktive punuese. Mundësitë e rritjes së popullsisë aktive në Komunën e Rahovecit është privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore si dhe gjetja e tregut për plasimin e prodhimeve bujqësore si që janë: prodhimet e rrushit (raki; verat etj), peme dhe perimet dhe ngritja e një objekti për përpunimin e perimeve që kultivohen në komunën e Rahovecit. Komuna e Rahovecit ka potencial bujqësor për kultivimin e prodhimeve sepse ka edhe sistemin e ujitjes (3.500 ha.).

Komuna e Rahovecit edhe sot e kësaj dite ka dominim të popullsisë agrare. pjesa më e madhe e popullsisë në komune merret me veprimtari agrare dhe atë me rreth 50 %. Bazuar në digjitalizimin e ortofotove dhe dokumenteve tjera, punës në terren, të dhënave që janë siguruar nga shërbimet zyrtare komunale, si dhe llogaritjeve tona, gjithnjë në kontekstin e shfrytëzimit dhe destinimit të sipërfaqeve në nivelin komunal, mund të konkludohet se territori i komunës së Rahovecit zë sipërfaqen prej 27589 hektar, në të cilin territori zhvillohen aktivitete të shumta humane.

Kategoria hapësirë	Sipërfaqe në Ha	%
Pyje	7293.24	26.4%
Livadhe	710.25	2.6%
Kullosa	3299.73	12.0%
Sipërfaqe bujqësore	12556.98	45.5%
Zonat e ndërtuara	1239.2	4.5%
Vreshta	2225.61	8.1%
Varreza	67.77	0.2%
Degradime	196.62	0.7%
Totali	27589.4	100.0%

Në këtë territor jetojnë 56208 banorë, të organizuar në një qendër urbane dhe 35 vendbanime rurale që gravitojnë në 7 qendra lokale. Mbi gjysma e numrit të

vendbanimeve shtrihen në zonën e rrafshët kurse zgjerimi i tyre bëhet në mënyrë të pakontrolluar, gjithnjë në dëm të sipërfaqeve bujqësore të kategorisë së lartë.



5.3.2 Blegtoria

Industria e blegtorisë konsiderohet lëmi tjetër kyçe e bujqësisë në Rahovec.

Ka karakter ekstensiv, pasi që kultivohet në numër të vogël nga fermerët. Rriten tri lloje të gjedheve, ku raca më e shpeshtë quhet Bushë e cila është më pak produktive në qumësht se të tjerat.

Prej blegtorisë kultivohen: gjedhet, delet, dhitë, kuajt, buallicat, etj. Kohëve të fundit ka tendencë të kalimit të kësaj dege të bujqësisë në blegtori intensive, me përmirësimin e racës së gjedhit, me racë simentale, montafone etj. Për mbarëvajtjen e blegtorisë në komunën e Rahovecit kujdeset stacioni i veterinarisë në Rahovec që nga viti 1960.

Nga të dhënat më të reja nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të KK Rahovec, kemi: Gjedhe të imta 7084; Gjedhe të trasha 8892 dhe shpezë 38700 sosh.

Shpeztaria është poashtu e karakterit ekstensiv dhe përveq pulës e cila kultivohet në numër më të madh, llojet tjera të shpezëve janë më pak, përderisa disa prej tyre mund të hasen në natyrë në formë të egër. Sipas kërkimeve tona jo të plota, mesatarja e pulave për familje sillet rreth 10 pula për çdo familje. Viteve të fundit ka filluar kultivimi intensiv i shpeztarise, ku janë ndërtuar disa mini-ferma të pulave, si në fshatrat Celinë,

Krushë të madhe, Apterushë, Qifllak etj.

5.4 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET E TRANSPORTIT

Komuna e Rahovecit shtrihet ne mesin rrugëve magjistrale Gjakove – Prishtine dhe Gjakove – Prizren, si dhe atyre rajonale Malisheve – Gjakove, dhe Rahovec – Suhareke.

Territori i komunës është relativisht i madh i cili ka një rrjet rrugorë prej 297 km rruge te te gjitha kategorive. Rrugët magjistrale dhe rajonale janë te asfaltuara dhe ne gjendje te mire ka edhe prej atyre brenda qytetit qe janë pa asfaltuara.

Gjendja e trafiku është relativisht ne nivel te kënaqshëm ne rrugët periferike te komunës ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit ka pak vështirësi ne zhvillimin normal te qarkullimit te mjeteve, kjo behet edhe me vështire kur kemi parasysh praninë e madhe te moto kultivatorëve. Konfiguracioni i terrenit është kodrinore ku karakterizohet me dendësi shumë te madhe vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë te ngushta te cilat përdoren nga te gjithë pjesëmarrësit ne trafik.

Shumica e këtyre rrugëve janë te asfaltuara mirëpo nuk kane trotuare për lëvizjen e këmbësoreve. Për nga aspekti i mobilitetit rrugët ne këto lagje mund te cilësohen si te rrezikshme duke mos i ofruar siguri te mjaftueshme te gjithë pjesëmarrësve në trafik.

Komuna përveç trafikut rrugore ka edhe atë hekurudhore e cila e lidhe Prizrenin – Fushe Kosovën, mirëpo aktualisht kjo linje është jashtë funksionit.

Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbehet nga:

- Rrugët magjistrale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë)
- Rrugë regjionale - (R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xerxë
- Ratkoc-Kramovik, R204 Rahovec- Krushë e Madhe, R110 Malishevë-Rahovec – Xerxë
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshire edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Tabela 21. Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
01	Rrugë magjistrale	6.51	1%
02	Rruge regjionale	64.37	20%
03	Rruge urbane	67.37	12%
04	Rruge lokale	109.47	19%
05	Rruge të pa kategorizuara	315.24	56%
TOTALI		562.96	100%

Grafiku 20. gjatësia e rrugëve në km sipas kategorive në komunën e Rahovecit

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 562.96 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë magjistrale janë 6.51 km (1.0%), Rrugë regjionale 64.37 km (20.0%), Rrugë lokale 109.47 km (19.0%), Rrugë urbane 67.37 km (12.0%) dhe Rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 315.24 km (56.0%).

5.4.1 Rrugë magjistrale M9.1

Nëpër territorin e komunës së Rahovecit kalon rruga e rëndësishme në nivel nacional e cila i lidhë Prishtinën-Gjakovën dhe me Shqipërinë e Veriut (Nëpërmjet qafës së Morinës) e cila cilësohet si rrugë magjistrale. Kjo rrugë në komunën e Rahovecit ka një gjatësi prej 4.5 km, si dhe kalon në dy komuna kadastrale.

Komunat kadastrale (vendbanimet) në të cilat kalon rruga magjistrale M9.1 janë: Kramovik, Mrasor.

Pozita e mirë gjeografike i ka mundësuar kësaj komune lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor dhe hekurudhorë. Gjithashtu e karakterizon atë me komunikacion mjaft të dendur, si në transportin e mallrave po ashtu edhe atë të udhëtarëve.

Rruga magjistrale e cila shtrihet në territorin e komunës është e asfaltuara dhe menaxhohet nga MTPT. Sipërfaqja e tokës e cila shfrytëzohet nga aktivitetet e rrugës magjistrale janë gjithsej 4.5 ha. Gjendja e rrugës magjistrale në komunën e Rahovecit, në përgjithësi është e mirë.

Karakteristikë e kësaj rrugë është shtrirja e urave (mbikalime) në raport me hekurudhën dhe me rrugë që e lidh Gjakovën me Klinën.

5.4.2 Rrugë regjionale

Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Rahovecit lidhje shumë të mirë në nivel regjional dhe kanë shtrirje në pesë drejtime me gjatësi prej 64.37 km. Gjithashtu këto rrugë janë të asfaltuara dhe menaxhohen nga MTPT:

- a) Rruga R-107 , Prizren-Xërxë- Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km
- b) Rruga R-110, Malishevë – Rahovec-Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km
- c) Rruga R111 , Xërxë –Ratkoc-Kramovik me gjatësi prej 17 km
- d) Rruga R117 , Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km

- e) Rruga R204, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km

f) Rruga regjionale R-107, Prizren-Xërxë- Gjakovë i mundëson komunës së Rahovecit lidhje të mirë me komunën e Prizrenit dhe të Gjakovës dhe rrugët regjionale R111 që lidhet me komunën e Klinës. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjaft të rëndësishme si (Krushë e Madhe, Celinë, kalon në komunën kadastrale të fshatit Bellacerkë dhe Xërxë). Kjo rrugë ka gjatësi 11 km në territorin e komunës së Rahovecit.

g) Rruga regjionale R110, – krijon lidhje të mira në mes të komunës së Rahovecit dhe Malishevës dhe pastaj nëpërmjet kësaj rrugë lidhet edhe me Prishtinën (Rahovec-Malishevë – Prishtinë)– kalon në pjesën qendrore të komunës së Rahovecit e deri në kufiri komunal i Malishevës.

Kjo rrugë ka gjatësi prej 16.3 km, dhe i prekë komunat kadastrale të: Xërxë, Bellacerkë, Bërnjak,dhe komunën kadastrale të qytetit të Rahovecit).

h) Rruga regjionale R111, Xërxë –Ratkoc -Kramovik - shtrihet kryesisht në pjesën perëndimore të komunës me gjatësi prej 17 km.

Nëpërmjet kësaj rruge komuna e Rahovecit ka qasje ne magjistralen Gjakovë-Prishtinë dhe me komunën e Klinës.

5.4.3Rrugë urbane

Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin lagjet e qytetit të Rahovecit, gjithsej rrugë urbane në qytetin e Rahovecit kemi 67.37 km ose 12.0% nga totali i përgjithshëm i rrugëve.

5.4.4Rrugë lokale

Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme të cilat mundësojnë lidhje të mira me to. Gjithsejtë rrugë lokale në komunën e Rahovecit janë 109.47 km ose 19.0% nga totali i përgjithshëm i rrugëve.

5.4.5Rrugë të pa kategorizuara

Konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të komunave kadastrale. Gjithsej rrugë të kësaj kategorie në tërë territorin e komunës së Rahovecit janë 315.24 km ose 56 %, e totalit të rrugëve. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtrutura me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

5.5 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË UJËRAVE

5.5.1Furnizimi me ujë

Qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:

- Sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i KRU Gjakova
- Sistemet e vogla -ujësjellësit lokal (sistem të pompimit)
- Puset individuale

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë kur në shumë raste uji pijës keqpërdorët edhe për ujitjen e tokave.

Sistemi i ujësjellësit të Radoniqit e furnizon me ujë qytetin e Rahovecit dhe vendbanimet Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xerxë, Bellacerkë, Bërnjakë, Krushë e Madhe, Celinë, Brestovc, Hoqë e Vogël, Hoqë e Madhe , Dejnë, Nushpalë, Sopniq, Potočan e Epërm, Potočan i Poshtëm, Reti e Ulët, Vrajak dhe Nagavc dhe tash se fundi fshatrat Dabidol, Çifllak, Kramovik, Polluzhe dhe Pastaselë. Në këtë sistem kanë qasje 56208 banorë ose 87 % të popullatës të përgjithshme në komunë.

Nga ky sistem, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në

ditë. Krahasuar me nivelet e BE-së, konsumimi i ujit për kokë banori është i mirë. Përkundër këtij kapaciteti të madh të ujit nga KRU Gjakova, gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta).

5.5.2Infrastruktura dhe shërbimet e furnizimit me energji elektrike

Rrjeti elektroenergjetik në Komunën e Rahovecit është permirsuar pas perfundimit të projektit për ndërtimin e TS 110/35/10(20)kV i cili ndodhet në dalje të Rahovecit në drejtimin e Xërxes, dhe linja 110kV nga Theranda ne Rahovec

Linja kabllovice 35kV fillon nga TS 110/35/10(20)kV – Rahovec dhe furnizon trafostacionet ekzistuese: TS 35/10(20)kV – Rahovec dhe TS 35/10(20)kV – Xerxë.

Gjithashtu edhe linjat kabllovice te reja nga TS I RI 110/35/10(20)kV deri te 35/10(20)kV kanë ndihmuar në përmirsimin e situates elektroenergjetike.

- Situata elektroenergjetike në komunën e Rahovecit është mjaft e mirë sa l përket furnizimit me energji elektrike. Në disa zona të caktuara rrjeti duhet të përmirsohet dhe të shtohen kapacitete energjetike duke shtuar numrin e transformatorve 10(20)/0.4kV.

Pra rrjeti i energjise elektrike te tensionit te larte dhe te mesem ne komunen e Rahovecit është mjaft mire e mbuluar, shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, edhe pse ne disa pjese te caktuara te komunes nevojitet shtimi l kapaciteteve, pra transformatorë të ri në menyre të permirsimit të metejmë te rrjetit elektrik ne komune. Nga gjithsejtë 36 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë 34.3 km e rrjetës energjetike gjendet në zonën kopshteve. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike ne të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kv në 20 kv.

5.5.3Infrastruktura dhe shërbimet e telekomunikacionit

Ekzistojne disa operator të cilet bëjnë shperndarjen e sherbimeve të internetit ne komunen e Rahovecit. Territori i komunes nuk është l mbuluar plotesisht me sherbime të internetit, kryesisht nuk jane te mbuluara viset malore dhe disa pjese të vendbanimeve rurale. Kryesisht interneti ne zonat rurale eshte l shperndare në nivel të internet kafe-ve, te cilat ofrojnë sherbime në vendbanime të ndryshme, si dhe kane qellime komerciale. Operatoret me ndikim me te madh, qe ofrojne sherbime te internetit ne komunen e Rahovecit jane:

- PTK - Darda NET, nëpërmjet të telefonise fikse
- 2. IPKO – ofron sherbime te internetit nepermjet te antenave (individuale) dhe
- 3. KUJTESA - ofron sherbime te internetit nepermjet te antenave (individuale)

5.5.4Menaxhimi i mbeturinave

Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në Komunën e Rahovecit, shërbimi i


grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët. Pavarësisht mbulueshmërisë prej 100%, prap se prap haset në deponi ilegale si dhe hudhje e mbeturinave në mënyrë të pa kontrolluar, po ashtu janë të evidentuara edhe “hot-spotet” (pikat e ndjeshme) të ndikimeve mjedisore në këtë komunë me theks të veçant në sektorin e mbeturinave, sipas raportit për mbeturinat i botuar më 2014, i cili është përgatitë nga Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit i Kosovës (AMMK), Komuna e Rahovecit cilësohet të ketë ndikim prej 3-5ha të hapësirës komunale të mbuluar me deponi ilegale.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo te plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve;
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave;
- Mospagesa e një pjesë të përfituesve të shërbimit;
- Mos zgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve);
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore;
- Shkalla e ulët dhe informale e ndarjes dhe riciklimit.

Aktualisht operatori me i madh është NJP “Ambienti” e cila sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonën urbane dhe rreth 27% në zonat rurale. Kurse operatori tjetër “Ekodrinia”, shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Me gjithë përparimet e shënuara, disa kategori të mbeturinave paraqesin një sfidë jo të lehtë për komunën, në veçanti mbeturinat ndërtimore/demolimet, mbeturinat shtazore, etj.



5.6 FATKEQËSIT NATYRORE

5.6.1 Vërshimet

Zonat që numd të goditen më së shumti: Fshatrat - Fortesë, Sapniq, Krushë e Madhe, Celinë, Çifllak, Dejn, Xerxe, Gexhe, Radoste, Ratkoc dhe pjesa jugore e qytetit të Rahovecit (Nënqyteti), etj.

Vërshimet janë uji i tepërt i shtratit i cili del nga lumi apo përroi dhe derdhja e ujërave të tepërta në fushën e afërt lumore, brigjeve të ulëta. Vërshimet janë rreziku më i shpeshtë i ambientit por edhe i objekteve në ato sipërfaqet e vërshuar. Por, ka raste që ato marin edhe jetën e njerëzve. Arsyeja qëndron në shtrirjen e gjerë gjeografike të lumit – përrenjve të vërshuar nga përmytja e derdhjeve të ujit, si rrjedhim i shirave intensive në brigje të ulëta.

Në territorin e komunës sonë, vërshimet janë rreziku më i shpeshtë i ambientit.

Vërshimet, zakonisht shkaktohen nga përmytja e derdhjeve të ujit, si rrjedhim i shirave intensive, dhe ngushtimit të shtratit të përroit të mbushura me material të ngurtë etj.

Vërshime mund të jenë:

- Vërshimi i lumit,
- Vërshime të shpejta nga përrenjtë,
- Vërshimi nga lëkundja (shpërthimi) i mundshëm të digës – nivelit të liqenit Radoniqi.

Vërshimet breglumore përfshijnë:

- derdhjet nga shtretërit e lumenjve ose vërshimet e lumenjve,
- vërshimet e shpejta,
- vërshimet lymore,
- vërshimet nga shpërthimi i digës.

Nuk ka shenja shumë të dallueshme ndërmjet vërshimeve të lumenjve, vërshimeve të shpejta, vërshimeve lymore dhe vërshimeve nga çarja e digës.

Shiu, zakonisht, në këto raste ka shtrirje të gjerë dhe është i rreptë. Niveli i vërshimeve mund të jetë i lartë dhe ndikohet nga veçoritë topografike.

5.6.2 Erozioni

Territori i Komunës së Rahovecit ka llojllojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet me numër të madh të grupeve të llojeve të tokës, e në përbërjen e saj ka 8 lloje dhe 21 nënlloje, në formë të një mozaiku. Me përjashtim të tokave skeletore, tokat tjera janë nga supstratet e bartura. Ato janë formuar pjesërisht nga sedimentet liqenore dhe rrjedhjeve të ujërave.

Prezenca e llojeve të ndryshme të tokave ofron mundësi për zhvillimin e kulturave të shumëllojshme.

Në këtë rast është me rëndësi ndikimi i njeriut në shfrytëzimin e tokës gjë që shpeshherë mund të shprehet negativisht nëse nuk i përshtatet lloji i kulturave llojit të tokës, sepse shfrytëzimi jo racional shkakton erozion dhe shkatërrim të tokave.

5.6.3 Tërmetet

Energjia sizmike transmetohet në sipërfaqen e tokës nga thellësia në formë dridhjes. Dridhjet shkaktojnë dëme dhe rrënimë të strukturave që përcillen me vdekje dhe lëndime. Dridhjet, gjithashtu, mund të shkaktojnë shembje të dheut, shembje të shkëmbinjve, lëngëzim të tokës dhe dëme të tjera të saj, duke dëmtuar vendbanimet në afërsi, duke shkaktuar zjarre të shumta, aksidente industriale ose në transport dhe duke rrezikuar me vërshime shkatërrimet digave të liqenit.

Tërmeti është një dukuri kur ndodhin dridhje të fuqishme në tokë, kur lirohet energjia e tepërt brenda një kohe të shkurtër, duke shkaktuar tronditje të papritura 15-50 km. nga epiqendra e tërmetit.

5.7 MJEDISI

5.7.1 Gjendja e mjedisit

Njerëzit tani janë në rrezik nga ngjarjet ekstreme gjeofizike – natyrore, siç janë: vërshimet, tërmetet, ortekët, thatësira, zjarret etj. Si rrjedhojë mund të thuhet se kanosja e fatkeqësive të reja, i ka karakteristikë të padëshiruara, që mund të kenë efekte tepër të përhapura dhe në të njëjtën kohë vështirë do të neutralizohen.

Ndotja e mjedisit është një problem mjaft serioz, prezent pothuaj kudo në territorin e Kosovës e poashtu edhe në komunën e Rahovecit

Rahoveci ka një mjedis relativisht të pastër, por ajo është larg nga të qenit jo e ndotur. Ndotja dhe degradimi i mjedisit në këtë komunë bëhet më së shumti me:

- a) lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj,
- b) hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve, prerja e drunjëve dhe dëmtimi i pyjeve pa kriter.

Studimet hulumtuese dhe profesionale për përcaktimin e normës së ndotjes (ujit, tokës dhe ajrit) në komunë nuk janë bërë ende. Ky problem nuk është i pranishëm vetëm në komunë, por është i pranishëm edhe në nivel vendi. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të përmirësojë ndjeshëm gjendjen në mbrojtjen e mjedisit.

5.7.2 Ndotja e ajrit

Të dhënat për cilësinë e ajrit në Kosovë janë të mangëta për shkak të mungesës së një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit. Gjithashtu, inventari i ndotësve nuk është zhvilluar ende nga kadastra e ndotësve të ajrit.

Si rezultat i kësaj gjendje nuk mund të flasin me kompetencë për nivelin aktual të ndotjes dhe cilësinë e tij. Bazuar në njohuritë e përgjithshme mbi situatën në Kosovë dhe sondazheve në terren, burimet kryesore të ndotjes në komunën e Rahovecit mund të konsiderohet se janë:

- Pluhuri, si pasojë e gurethyesve
- Gazrat e liruara nga makinat e vjetra dhe pa katalizator.
- Ndezja e mbetjeve të plastikës dhe gomës
- Ndezja e mbetjeve në deponi të egra
- Shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak;

5.7.3 Ndotja e ujit

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në Komunën e Rahovecit, është si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në ambientet ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edhe ku ka shtrirje aktiviteti njerëzor.

Në shkallën e parë që, nuk ka ndotje kimike dhe biologjike, janë lumenjtë që shtrihen nga burimet deri në vendbanime.

Shkallës IIa të ndotjes i takojnë të gjithë lumenjtë dhe prroskat e komunës së Rahovecit dhe shkallës i takon Drini i Bardhë.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit. Mesatarisht çdo banor shkarkon $16.46 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra të zeza.

Në bazë të statistikave demografike numri i banorëve në Komunë është 56208 banorë, atëherë $56208 \times 16.46 = 925183 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra të zeza ose 49 litër/sek pa llogaritur objektet industriale.

Vendbanimet nuk kanë të rregulluar kanalizimin, përveç 9 prej tyre, por fatkeqësisht edhe ato vendbanime pa trajtim paraprak ujërat e zeza i shkarkojnë në mjedise të pastra.

Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka.

Përveç ndotjes kimike të ujërave, ku ndotësit hynë si përbërës i ujit, është ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike, ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për jetën e njeriut, florën dhe faunën që shtrihet përgjatë shtratit të lumit. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet për botën e gjallë natyrore të ujërave.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta është dukuri tjetër negative e lumenjve të Kosovës, por edhe të vendbanimeve të komunës. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

5.7.4 Ndotja e tokës

Duke pasur parasysh faktin se substancat e rrezikshme janë të pranishme në komunitetet anekënd botës, kryesisht në zonat industriale dhe gjatë transportimit nëpërmjet autostradave, hekurudhave dhe kanaleve të ujërave. Aksidentet, duke përfshirë këtu zjarret, eksplozimet dhe rrjedhjet, që e shkaktjnë lirim të këtyre substancave, mund t'i dëmtojnë shumë shëndetin e njeriut, pronën dhe mjedisin e tij. Ekspozimi i njeriut ndaj substancave të rrezikshme mund të shkaktojnë lëndime, madje edhe vdekje, të një numri të madh njerëzish. Ky ekspozim mund të ndodh drejtpërsëdrejti, me anë të ekspozimit të syrit, me kontakt në lëkurë, me inhalim, gjatë kapërdirjes, ose si rezultat i ndotjes së ujit a të dheut, që mund të ndikojnë në prodhimin e ushqimit.

Popullata e rrezikuar në rast aksidenti (ose "publiku potencialisht i goditur") është kryesisht, ose në zonën industriale, ose shumë afër saj, pran rrugëve të transportit, edhe pse popullata mund të goditet edhe me anë të ujit të ndotur ose të prodhimeve ushqimore. Rrallëherë ndodh që popullata e ekspozuar të jetë më larg nga vendi i fatkeqësisë.

Për qëllime të këtij kursi, të lidhur me parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj aksidenteve teknologjike, vëmendja përqendrohet tek aksidentet në pajisjet e

instaluara të palëvizshme, që përmbajnë substanca të rrezikshme dhe që mund t'i godasin njerëzit, pasurin ose mjedisin edhe pse shumë prej tyre ndodhin gjatë transportit. "Pajisjet e instaluara të palëvizshme", - në kuptim të gjerë, - përkufizohen si uzina ose vende që prodhojnë, përpunojnë, përdorin, trajtojnë, ruajnë ose hedhin substanca të rrezikshme. Kështu, pajisjet e instaluara të palëvizshme përfshijnë uzinat e prodhimit të substancave të rrezikshme dhe vendet e tjera industriale, në të cilat përdoren ose përpunohen substancat e rrezikshme; depot që përmbajnë këto substancash; vendet ku hidhen këto substanca etj.

5.7.5 Ndotja akustike

Sa i përket ndotjes nga akustike nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme.

Fakti që përmes territorit të komunës kalon rruga Magjistrale M-9.1 Gjakovë – Klinë, si dhe rruget regjionale ,: Rruga R-107 , Prizren-Xërxë- Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km, Rruga R-110, Malishevë – Rahovec-Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km, Rruga R111 , Xërxë –Ratkoc-Kramovik me gjatësi prej 17 km, Rruga R117 , Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km, Rruga R204, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km.

Kjo do të thotë se komuna është e ndikuar nga zhurma .

Gjithashtu ndotësit tjerë janë veprimtaritë përpunuese/industriale siç janë fabrikat e betonit/çimentos pranë vendbanimit dhe gërmimet grumbulluese (gurthyesit) brenda territorit të komunës.

5.7.6 Klima

Faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në klimën e këtij regjioni janë: pozita e favorshme gjeografike, distanca e vogël nga deti Adriatik (102 km deri në deltën e Drinit të Bardh në Adriatik), lartësia mesatare mbi nivelin e detit (rreth 308 në luginën e lumit Drini i Bardhë dhe 1039 në maje të Zatriqit, që do të thotë se mesatarja është 550 m për gjithë zonën e komunës, pengesa e malit të Shkozës, Zatriqit dhe Koznikut, rritja e vegjetacionit dhe kafshëve (pyll, fushë, ferma etj).

Në komunën e Rahovecit temperatura mesatare është 11.680 C, maksimumi ndodh në Korrik në 38.5 0C, përderisa minimumi është në Janar në -14,5 0C.

Reshjet maksimale në Rahovec janë 1047.2 mm, përderisa minimalet janë 609.9 mm. Reshjet mesatare janë 707.7 mm. Reshjet e borës janë më të mëdhatë në Janar. Ditët me borë në Rahovec përafërsisht janë rreth 15.7 ditë. Rahoveci e ka mesataren vjetore prej 19.7 ditë me mjegull, apo 5.4%

5.7.7 Hidrografia

Në territorin e komunës së Rahovecit ka disa qindra burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e prockave – projeve dhe rrëzë kodrinave. Më së shumti ka burime në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Zoqishtës, Apterushës, Vrellën në qytetin e Rahovecit, etj. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Hulumtimet tregojnë se më së shumti ka burime karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jug- perëndim, veri dhe veri-perëndim, në rrëzë të malit Shkozës, Zatriq dhe Kaznik.

5.8 RRJETI I SHERBIMEVE

5.8.1 Institucionet shëndetësore

Angazhimi i strukturave vendore, edhe pse me shumë vështërsi, si dhe përkrahja dhe bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare sot e ngrenë konceptin e mjekësisë familjare në Kosovë, të paktën në pasurimin e njohurive teorike, në nivel të njëjtë me të gjitha vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu edhe në Strategjinë shëndetësore të Kosovës 2005-2015, mjekësia familjare është sektor mjaft me rëndësi në zbatimin e synimeve dhe prioritetëve shëndetësore kryesore të identifikuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në komunën e Rahovecit shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore.

Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 16 objekte shëndetësore:

- QKMF-1 Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytetin e Rahovecit
- QMF -7 Qendra e Mjekësisë Familjare në: Ratkoc, Bellacerkë (Fortesë), Qifllak, Drenovc, Krushë e Madhe, lagja e Arave dhe Apterush
- AMF -7 Ambulanca të Mjekësisë Familjare në: Lagja e Eperme, Hoqe e Madhe, Zaqisht, Brestoc, Radostë, Polluzhë dhe Xërxë.
- Qendra për punë sociale.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Rahovec, si bartëse e kujdesit primarë, është e vendosur në qytetin e Rahovecit dhe ka gjendje fizike të kënaqshme. Kjo qendër mbulon me shërbime territorin e Rahovecit dhe fshatrat përreth. Në këto institucion janë të punësuar gjithsej 87 punonjës, 28 mjek dhe 59 infermier - teknik.

5.8.2 Institucionet arsimore

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X – XII).

Numri i objekteve shkollore gjithsejtë është 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit janë të angazhuar rreth 837 punëtorë, prej të cilëve janë 726 mësimdhënës. Numri i nxënësve është gjithsej 10833, që do të thotë se kemi një raport prej 15 nxënës /mësimdhënës (edukator).

6. VSM - VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PZHK-se

PZHK është zhvilluar duke u bazuar në principet e mëposhtme. Ato janë principe të përgjithshme që duhet të ndërmerren nga PZHK-ja duke u ngritur nga korniza legjislative e një niveli më të lartë dhe Planin Hapësinor të Kosovës (zhvillim i qëndrueshëm dhe kohezion social).

Rahoveci si shumica e qyteteve të tjera përballet me një sërë problemesh mjedisore, si psh.degradim i madhë i mjedisit cilësi e dobët e ajrit, nivel i lartë i trafikut, nivel i lartë i zhurmës së ambientit, toka të braktisura, emisione të gazrave, etj. Këto

problem lidhen me një zhvillim urban që nuk është i orientuar drejt zhvillimit për një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. Principet e përgjithshme për zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit ofrojnë një kornizë direktivash të cilat vijnë nga një planifikim i rëndësishëm dhe dokumente zhvillimore në nivelin vendor, Evropian, dhe botëror: Ligjet dhe udhëzimet administrative në Planifikimin Hapësinor dhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020; Principet udhëzuese për zhvillim të qëndrueshëm BE (nga strategjia tematike për direktivat mjedisore urbane për qytetet e së nesërme) Principet për zhvillim të qëndrueshëm – Agjenda 21

Për të kundërshtuar aspektet negative të listuara më lartë, janë listuar më poshtë disa principe të rëndësishme.

6.1 Kriteret e zonimit të orientuara nga mbrojtja e mjedisit dhe kohezionit social

Përcaktimi i hapësirave të caktuara duhet të përmbushë kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, duke ngritur cilësinë e jetës dhe shëndetin publik në këtë zonë, dhe përdorimin racional të burimeve natyrore (psh: hapësirat për banim, sport dhe argëtim nuk mund të jenë pranë kapaciteteve industriale; hapësirat për banim dhe për të gjitha qëllimet e tjera, përveç agrikulturës, nuk mund të jenë në kategoritë e tokave bujqësore I deri IV, etj.).

Gama e efekteve të mundshme të mjedisit në konsiderim ka qenë e informuar fillimisht nga :

Direktiva e VSM-së. Aneks 1 i Direktivës së VSM-së kërkon që vlerësimi të përfshijë informacione në —efektet e rëndësishme e të mundshme të mjedisit, duke përfshirë çështjet sikur: biodiversiteti; popullata; shëndeti i njeriut; bota bimë; bota shtazore; drithëra; uji; ajri, toka; faktorët klimatikë; pasuritë materiale; trashëgimia kulturore, përfshirë edhe trashëgiminë arkeologjike dhe arkitektonike; peizazhi; dhe marrëdhëniet e brendshme ndërmjet çështjeve të lartpërmendurall. Në mungesë të drejtimit të detajuar në përmbajtjen e tyre, një numër i këtyre kategorive mjedisore (p.sh.: popullsia, shëndeti i njeriut dhe pasuritë materiale) mund t'i nënshtrohen interpretimeve të ndryshme. Në kuadër të këtij raporti :

-popullatall përfshinë të dhënat mbi demografinë dhe çështjet kryesore sociale dhe socioekonomike duke përfshirë çështjet e çasjes;

-shëndeti i njeriutll përfshinë të dhëna mbi mortalitetin, sëmundjet dhe mirëqenien e njeriut;

-asete materialell përfshijnë të dhënat mbi menaxhimin e mbeturinave

Përdorimi i tokës nuk është identifikuar në listën e 12 temave të VSM-së; megjithatë për qëllimet e këtij vlerësimi dhe në veçanti duke pasur parasysh se këto janë vlerësimet e strategjisë, objektivat e para të të cilave përfshijnë përcaktimin e vendndodhjes së zhvillimit, është përshkruar në temën e tokës.

Elementet e Përfshira në VSM	Kategoritë e përdorura gjatë vlerësimit Strategjik Mjedisor
Popullsia	Popullsia (numri i popullsisë, përfshirë efektet socio-ekonomike dhe qasja)
Shëndetësia e popullsisë	Shëndetësia e popullsisë
Toka	Toka(përfshirë shfrytëzimin e tokës, zona të rëndësishme geologjike, ndotja e tokës
Uji	Burimi dhe cilësia e ujit (përfshirë ujërat e freskët të sipërfaqes dhe ujërat nëntokësor, lumenjet , erozioni)
Ajri	Cilësia e ajrit, kualiteti i cilesise se ajrit – monitorimi dhe raportimi

	i cilesise se ajrit
Faktorët klimatikë	Ndryshim i klimës (përfshirë emetimet e gasit të Serrave, efektet e parashikuara nga ndryshimi i klimës sikur: përmytjet dhe aftësitë për t'u përshtatur- adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike
Mbeturinat	Menaxhimi i qendrueshem i mbeturinave
Ujerat e zeza	Trejtimi i ujerave te zeza
Trashëgimia natyrore dhe trashëgimia kulturore,	Trashëgimia natyrore (monumentet e natyres si trashëgimia kulturore kulturore (përfshirë trashëgiminë arkologjike dhe arkitektonike)
Energjia	Furnizimi me energji elektrike
Bujqësia	Menaxhimi i tokave dhe shfrytëzimi i tyre
Biodiversiteti, bota bimore dhe bota shtazore	Ruajtja e biodiversitetit dhe natyrës(që përfshinë botën bimore dhe shtazore, dhe funksionimi i ekosistemeve

6.1.1 SWOT analiza gjat hartimit të PZHK

Swot analiza e pergjithshme	
Përparësitë ☐ Cilësia e ajrit ☐ Burimet natyrore ☐ Biodiversitet i pasur ☐ Cilësia e tokës bujqësore ☐ Cilësia e pyjeve	Dobësitë ☐ Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtura ☐ Deponitë joformale të mbeturinave ☐ Prerja dhe dëmtimi i pyjeve ☐ Ndërtimet dhe ndotja e tokës bujqësore ☐ Ndotja nga trafiku ☐ Ngrohja individuale e objekteve ☐ Mostrajtimi adekuat e etheve hemorragjike
Mundësitë ☐ Rigjenerim i pyllit ☐ Përkufizimi i zonave për mbrojtjen e tokës bujqësore ☐ Trajtimi i ujërave të zeza ☐ Avancimi i menaxhimit me mbeturina ☐ Mirëmbajtja dhe rregullimit i shtratit të lumit ☐ Masat anti-erozion ☐ Studimi i biodiversitetit ☐ Promovimi i vlerave mjedisore ☐ Bashkëpunimi ndër-komunal	Rreziqet ☐ Degradimi i mjedisit - ujit, ajrit, tokës ☐ Ndikimi negativ në shëndetin e banorëve ☐ Ndikimi negativ në biodiversitet ☐ Humbja e tokës bujqësore ☐ Rreziku i shendit nga ethet hemorragjike ☐ Rreziku nga vërshimet ☐ Rreziku në zonat erozive

7. PSE ËSHTË I NEVOJSHËM VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim njerëzorë dhe ekonomik që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara.

Bazuar në parimin mjedisor të —parandalimit. sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha

vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM).

Procesi i VSM-se është një detyrim ligjor për politikat, planet apo programet. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive

8. MASAT PËR PARANDALIMIN E DËMTIMIT TË NDIKIMEVE TË MJEDISIT

Për rrjetin hipografik PZHK propozon përmirësimin e cilësisë së ujit, me heqjen graduale të mbeturinave të cilat ende ndikojnë në disa pjesë, dhe të bankave, me një program të veprimeve për secilin kanal që siguron rehabilitim të vlerave mjedisore dhe natyrore, duke forcuar aktivitete rekreative, pasurimi i biomasës buke mbjellur pemë dhe shkurre për të kompletuar skajet e peizazhit bujqësor, duke ruajtur elementet e mbetura historike të peizazhit. Matje të shumta kushtuar mbrojtjes së mjedisit (ruajtja e peizazhit, mbeturinat solide dhe përpunimin ujërave të humbura, politikat pylltarisë...) janë përmendur në paragrafët e mëhershme. Sidoqoftë, është e mundshme të radhiten matjet e veçanta të mëposhtme:

8.1 Reduktimi i ndotjes akustike

Për të reduktuar ndotjen akustike në zonat urbane duhet të ndiqen veprimet e duhura, dhe përmes ndërhyrjeve kushtuar pajisjeve dhe performancës së infrastrukturës, edhe nga ndërhyrjet direkte në burimet e zhurmës.

Për vendbanimet e reja, vlerësimi i ekspozimit të ndotjes akustike do të ndihmojë në çasje inovative në dizajn dhe konstruksion. Matjet për zbutjen e zhurmës, ku është e nevojshme, duhet të integrohen me mjedisin dhe të kontribuojnë në cilësinë e hapësirave urbane.

8.2 Reduktimi i ndotjes së ajrit

Për reduktimin e ndotjes së ajrit në ambientin urban, duhet të ndiqen veprat e duhura. Ndërhyrjet në vendbanimet e reja duhet të sigurojnë rritje të biomasës në zonat e gjelbërta, dhe të jenë në gjendje të absorbojnë ndotjen duke zvogëluar kështu përqendrimet.

8.3 Grumbullimi dhe perdorimi i ujit

PZHK duhet të marrë në konsiderim ndërtimin e sistemit të dyfishtë për ndërtesat e reja.

Në veçanti, në zonat e zhivillimit të ri, lehësimi dhe rehabilitimi, duhet të jenë të ndarë në disa sisteme për mbledhjen e ujërave të zeza të kushteve atmosferike, me qëllim që të ripërdorohen në përputhshmëri, edhe jashtë zonave në të cilat gjenden.

Ruajtja e ujit, për të reduktuar konsumimin e ujit të pijshëm, shiu do të mbledhet dhe do të përdoret si ujë për ujitje. Reduktim i mëtutjeshëm mund të arrihet duke përdorur instalime sanitare që rrjedhin ngadalë, duke ripërdorur ujërat e hirta aty ku duhet dhe implementuar sisteme gjeotermale në vend të kullave tradicionale ftohëse, të cilat përdorin një sasi të madhe të ujit të pijshëm. Sipërfaqet tokësore dhe kulmore duhet të jenë të dizajnuara të depërtueshme për menaxhim efikas të ujërave atmosferike.

8.4 Ruajtja e Energjisë

PZHK konsideron si prioritet për hartimin e një Plani për të përcaktuar ndërhyrjet për reduktimin e humbjes së nxehtësisë në ndërtesat ekzistuese dhe për të caktuar standardet e cilësisë për ndërtesat e reja, në linjë me udhëzimet Evropiane.

Efikasiteti duhet të arrihet nëpërmjet strategjive të zgjuara dhe të thjeshta që nuk kanë nevojë për teknologji komplet të reja. Kërkesat e energjisë do të minimizohen nëpërmjet zbatimit të strategjive pasive që aty ku është e mundshme të arrihen kërkesat e mbetura nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave të integruara. Aty ku është e mundur do të bëhet furnizimi me energji nga burimet e ripërtëritshme.

Strategjitë pasive përfshijnë:

- Fasada të izoluar me dritare
- Rregullimi i ndërtesave për verë dhe dimër me ngrohje dhe freskim për secilën stinë
- Shfrytëzim maksimal i dritës së diellit nëpërmjet ndërtimit të elementeve që tërheqin dritën
- Zonat buferike (si kopshtet dimërore) duhet të tërheqin energjinë diellore pasive dhe të lejojnë ventilim natyral nën kushtet dimërore
- Mbrojtje nga drita diellore e jashtme

8.5 Masat për parandalimin ndikimin negative social

Planifikimi dhe dizajni i të gjitha zonave do të sigurojë një mjedis që mund të mirëpresë një shoqëri të hapur me një diversitet të banorëve, njerëzve që banojnë aty, vizitorëve të qytetit. Njerëzit do të takojnë fqinjët e tyre dhe do të ndjejnë se i përkasin këtij komuniteti.

* Sigurimi i tipologjive të ndryshme të banimit

* Mbështetja e identiteteve të lagjeve të ndryshme

* Një rrjet publik hapësirë ku banorët duan të takohen me fqinjët dhe për të gjetur mundësi për të komunikuar

Programimi i hapësirave në natyrë do të sigurojë :

* Objektet për të luajtur

* Ulëse publike

* Fushat për evenimentet në natyrë dhe tubime të mëdha

* Zonat e sigurta, të gjelbërta dhe të qeta të lagjeve

8.6 Dispozitat në lidhje me bashkëpunimin

Për të koordinuar zbatimin e PZHK-së komuna mund të promovojë arritjen e marrëveshjeve territorial me komunat e tjera dhe me qeverinë, për shkak të integritetit të ngushtë dhe ndërruar të marrëveshjeve mbi vendbanimet dhe homogjenitetin e karakteristikave të natyrës, mjedisit dhe peizazhit të komunave.

Përmirësimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe ndërgjegjësimi Zbatimi dhe përforcimi i planeve zhvillimore dhe rregulluese do të jetë i suksesshëm vetëm kur komuna të

mund të krijojë ndjenjën e mbështetjes dhe besimit mes banorëve të saj. Një kampanjë mediale do të organizohet për të forcuar ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe të rrisin mbështetjen e tyre për planifikimin e aktiviteteve. Centralizimi i informacionit hapësinor Informacioni hapësinor i mundshëm do të qendërohet dhe integrohet në një sistem GIS që do të jetë i qasshëm të paktën nga të gjitha drejtoritë e administratës komunale. Lejet e ndërtimit Procesi I dhënies ose refuzimit të lejeve të ndërtimit, duke përfshirë garancion për rolet transparente të të gjitha palëve të interesuara (aplikantë, rezidentë, palë të tjera dhe administrate) do të përmirësohen me marrëveshje të qarta.

8.7 Dispozitat mbi rendin kronologjik ose fazat e zbatimit

Plani investitor komunal duhet të bëhet sipas veprimeve që kanë rezultuar si më të rëndësishme dhe urgjente sipas PZhK..

Në një kohë të shkurtër pas aprovimit final të PZhK, assembleja komunale duhet të aprovojë një plan buxhetor shtesë në të cilin shprehet qartë se si do të financohet zbatimi i këtyre planeve për vitet e para. Ky plan buxhetor shtesë duhet të përcaktojë përveç te tjerave edhe hartimin e PZHK, duke zbatuar inventarin dhe hartimin e studimeve shtesë të fizibilitetit, planeve sektoriale dhe instrumenteve të tjera që duhet të financohen.

Pas aprovimit përfundimtar të PZHK-së, Komuna duhet të rishikojë politikat e sektorit ekzistues për ti pasur të harmonizuara me komisionin e PZHK-së

8.8 Elementet dhe udhëzimet për hulumtime të mëtutjeshme

Studime dhe kërkime për identifikimin në kohë të zonave që duhet të mbrohen në lidhje me mbrojtjen e sipërfaqeve dhe burimeve me ujë nëntokësor, dhe gjendjen hidrologjike. Duhet identifikuar zonat në rrezik përmytjeje.

Definicioni i këtyre pjesëve të kodrës/malit për tu ruajtur, për të parandaluar format e përdorimit të tokës që mund të shkaktojnë shqetësim publik në formën e shpyllëzimit, humbjes së stabilitetit ose përkeqësimi i sistemit ujor.

Do të identifikohen si zona të ndikuara nga mungesa e stabilitetit dhe fenomeni erozionit (psh rrëshqitjet e tokës ose faza e rregullimit, duke rezultuar në kushtet morfologjike dhe klimatike: një fenomen që ndodh për shkak të kushteve morfologjike dhe klimatike shumë të ngjashme me të tashmen, në dukje stabile por që e kanë ezauruar zhvillimin e tyre dhe mund të riaktivizohen).

8.9 Gjelbërimi

Së bashku me gjelbërimin, duhet të jetë një zbukurim në përputhje me të gjitha kategoritë e rrugëve. Rrugët lokale dhe të qarkut në veçanti mund të zbukurohen me orë, me Fontana dekorative me ujë të pijshëm, si dhe ulëse për pushim . Zbukurimi duhet të përfshijë ndalesat e autobusëve, kabinat publike të telefonit, ulëset, shportat e bërllokut për këmbësorë, parkingje për biçikleta si dhe elemente tjera që prezantojnë kulture qytetare,

Në mënyrë që të sigurohet për qytetarët një ofertë e një qyteti cilësor, ne duhet të lidhim rritjen e popullsisë me ofrimin e pajisjeve të përshtatshme dhe të infrastrukturës. Situata aktuale të strehimit në të ardhmen e afërt do të gjenerojë një kërkesë të përhapur për përmirësimin e cilësisë së fondit ekzistues banesor; për më tepër pjesa tjetër e kërkesës për strehim të ri do të gjenerohet nga rritja e numrit të

familjeve, të lidhura me zvogëlimin e numrit të anëtarëve të çdo familje dhe në karakter të ri të popullsisë. Roli i vërtetë i kryeqytetit, pa politikat adekuate, bëhet një tjetër faktor tërheqës i popullsisë urbane, që ndikojnë në migrimin e brendshëm të kryeqytetit. Shtrirja e proceseve të fundit në një anë anon në boshtin qendror historik të lidhur me rrugët dhe hekurudhat, por nga ana tjetër kanë tendencë për të pushtuar mjedisin rrethues përderisa zonat e pyllëzuara dhe të vlefshme rrethojnë qytetin. Ekziston rreziku i humbjes së perceptimit të formës origjinale urbane dhe të marrëdhënieve të tij me mjedisin natyror përreth qytetit; një tjetër rrezik është dhe rritja e dendësisë së zonave qendrore, me pasoja të ndotjes së mjedisit. Ekziston rreziku i zhvillimit të periferive të zgjeruara, ku është e vështirë për të siguruar komoditet dhe cilësi jetësore.

Për të adresuar këto çështje ne propozojmë një strategji të bazuar në shtrirje të plotësishme të kualitetit urban "bazë" në aspektin e komoditetit dhe hapësirave publike; përshtatja me standardet evropiane të rrugëve, me ndërtimin e shtigjeve të këmbësorëve, Çiklisteve dhe parkingjeve të automjeteve, rritjen e rrjeteve teknologjike; rritja selektive e vendbanimeve, të vendosura në mënyrë për të rritur dhe ruajtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore dhe gjithmonë duke u mbështetur nga zhvillimi i infrastrukturës, komoditetit dhe hapësirave publike, mobilitetit të qëndrueshëm, rrjetet teknologjike. Në mënyrë për të vlerësuar rritjen e mundshme të vendbanimeve kufiri i sipërm i qëndrueshmërisë së popullsisë i krahasuar me nivelin e komoditetit dhe infrastrukturës në gjendje për të siguruar një nivel të mirë të cilësisë jetësore urbane, do të identifikohen:

- zonat e konsoliduar urbane, ku ndërtesat e reja janë të ndaluara, me përjashtim të vetëm për zëvendësimin e stoqeve ekzistuese; në këto fusha objektet publike, hapësira (dmth sheshet) duhet të forcohen si psh parqet, pajisjet adekuate, rrjetet rrugore duhet të krijohen si për këmbësorë njashtu dhe shtigjet e çiklisteve dhe parkingje për makina.
- kompletimi dhe kompresimi i zonave urbane (përmes hapësirës që gjinden në mes dy ndërtimeve ose rindërtim ndërhyrje). Duke marrë parasysh dendësinë e ulët të prezente, ne propozojmë lehtësimin e proceseve të densitetit, bazuar në një rritje prej 20 banesave / ha.
- përzgjedhja e zonave të zgjeruar, me krijimin e strukturës së re urbanistike, me dendësitë prej 50 banesave / ha (të përshtatshme për të mbështetur zhvillimin e transportit publik, komoditetit dhe bizneset në zonë urbane).

Kudo që të jetë e mundur, hapësirat e gjelbra duhet të rriten si për përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe për të rritur biodiversitetin. Për më tepër, lëvizja e qëndrueshëm duhet të jetë pjesë e një qasjeje të integruar. Reduktimi i ngjeshur është i rëndësishëm nëse e shikojmë nga pikëveshtrimi i shëndetësive, por kjo nuk është vetëm në lidhje me reduktimin e emisioneve të CO₂, ndotjes dhe zhurmës – ka lidhje gjithashtu për dhënie të mundësisë së qytetareve për ri-pushtim të qytetit. Rrugët me trafik të rëndë janë pengesa efektive që kalojnë nëpër qytete, ku izolojnë lagjet dhe i bëjnë të duken joatraktive. Objektet publike, së bashku me hapësirat komerciale dhe pasuritë e tjera të strukturave urbane, duhet të vendosen në një formë të përmbledhur në mënyrë që të ndërtojnë vende të gjalla dhe tërheqëse dhe gjallë të arritshme në këmbë ose me biçikletë.

Në duhet të inkurajojmë krijimin e modelit të përzier urbane, ku funksionon e banimit bashkëjetojnë me bizneset e vogla, zejtarisë, zyrat, që synon t'u japë vitalitet hapësirës urbane në kohë të ndryshme të ditës, për të reduktuar lëvizjet (parimi i afërsisë) dhe për të rritur sigurinë urbane.

8.10 Krijimi dhe sigurimi i hapësirave publike me cilësi të lartë

Sasia dhe cilësia e hapësirave publike luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kushteve të jetesës së popullsisë urbane. Si një faktor vendor, cilësia e hapësirës urbane është e rëndësishme për të tërhequr investimin industrial, burime njerëzore të afta dhe kreative, dhe për të rritur turizmin.

Cilësia dhe estetika e ambientit të ndërtuar dhe hapësirave publike janë faktorë të rëndësishëm për atraktivitetin e një qyteti. Hapësira publike tërheqëse që funksionojnë mirë dhe një mjedis në përgjithësi estetik mund të jenë simbole të një qyteti dhe të të jetuarit së bashku. Kjo i jep popullit ndjenjën e pronësisë së këtij qyteti. Idealja do të ishte që hapësirat publike të jenë shumë funksionale, miqësore për më të moshuarit dhe të mund të akomodojnë fëmijët, si dhe të jenë vend takimi dhe po ashtu ti shërbejnë funksioneve specifike.

Të bëjmë lëvizshmërinë e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të shëndetshme, një qytet që arrihet dhe udhëtohet lehtësisht

Zhvillimi i lëvizshmërisë së qëndrueshme është një sfidë kyçe për qytetet e së nesërme. Mobiliteti qëndrueshëm përfshin dimensione dhe përbërës të ndryshëm: sistem transporti i qëndrueshëm, efikas në harxhimin e energjisë dhe i përballueshëm; një ambient miqësor për mënyrat e transportit me biçikletë dhe në këmbë; qasje e lehtë në të gjitha lagjet në këmbë, biçikletë apo transport publik; rrjete urbane që duhen planifikuar në kontekstin e përdorimit gjithëpërfshirës të tokës dhe zhvillimit hapësinor; dhe nje transporti që duhet të integrohen mirë me aktivitetet sociale, kulturore, dhe ekonomike duke përfshirë argëtimin. Infrastruktura e lëvizshmërisë duhet të zhvillohet me një perspektive afatgjatë në të cilën merren parasysh nevojat për të ardhmen, zhvillimet urbane, hapësinore dhe teknologjike.

8.11 Një balance mes natyrës dhe traditës

Për aq sa është e mundur, territori i komunës së PZHK duhet të zhvillohet në një mënyrë të balancuar. Një balancë e zhvillimit me natyrën thekson se ka një nivel të intensitetit të banimit ku burimet që konsumohen do të zëvendësohet nëpërmjet cikleve natyrore të stinëve, duke krijuar kështu një ekuilibër mjedisor. Një balancë mes zhvillimit e natyrës ka si qëllim përdorimin racional të burimeve natyrore dhe një balancë më e mirë mes zhvillimit social, ekonomik, dhe mjedisor. Balanca me traditën ka si qëllim të integrojë ndërhyrjet e planifikuara me asetet kulturore ekzistuese, duke respektuar praktikat tradicionale. Ky princip i planifikimit urban kërkon respekt për trashëgiminë kulturore të vendit. Planet hapësinore, planet rregulluese dhe planet e menaxhimit përmbajnë masa gjithëpërfshirëse për të mbrojtur vlerat natyrore dhe kulturore, si dhe integritetin historik.

9. PRIORITETET ZHVILLIMORE STRATEGJIKE TE PZHK

9.1 Plani zhvillimor komunal Qëllimi dhe Objektivat e PZHK-se

Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit (PZHK) siguron një kornizë afatgjatë të zhvillimit të Komunës dhe qytetit, duke përcaktuar qëllimet afatgjatë të zhvillimit dhe duke identifikuar prioritetet strategjike.

Kjo kornizë duhet të sigurojë si:

- Ekonomi të zhvilluar dhe më shumë vende të reja të punës,
- Zhvillim të përparuar social dhe mundësi të barabarta për të gjithë

- Mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit, resurseve natyrore dhe kulturore
- Infrastruktura të integruar dhe shërbime efikase për qytetarët

Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit (PZHK), si plan shumë-sektorial i përcakton qëllimet afatgjata ekonomike, sociale dhe hapësinore të Komunës për periudhën 2018-2026, në harmoni me Planin Hapësinor të Kosovës.

Plani Zhvillimor Komunal është dokument strategjik, që përcjell një vizion të qartë për të cilin është arritur përputhja dhe angazhimi i të gjitha palëve të interesit, të specifikuar më tej përmes qëllimeve dhe drejtimeve strategjike. Duke qenë në rolin e harmonizuesit dhe udhërrëfyesit të zhvillimeve të ardhshme në Rahovec, në sfera të ndryshme të orientuara kah aktivitetet, PZHK-ja ofron mundësinë për të marrë vendime në lidhje me përdorimin e ardhshëm të hapësirës, përcaktimin e regjimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të tij, si dhe aktivitetëve socio - ekonomike dhe mjedisore në territorin e Komunës së Rahovecit.

Rëndësia e veçantë e PZHK-së, duke e pasur parasysh qasjen integruese përgjatë procesit të hartimit dhe karakterin shumë-sektorial, qëndron në zhvillimin e harmonizuar të mbështetur në potenciale të arritshme të Rahovecit.

Në procesin e planifikimit rol të rëndësishëm paraqet Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM), si një proces obligues dhe përcjellës i hartimit të PZHK, me qëllim të vlerësimit të ndikimeve potenciale mjedisore të këtij plani si dhe të përmirësimit të tij , duke sugjeruar objektiva apo strategji të reja apo duke i rishikuar ato ekzistuese.

Për PZHK të Rahovecit është zhvilluar procesi i VSM që në fazat fillestare të saj, duke u integruar tërësisht në procesin e hartimit, si dhe duke e ngritur cilësinë e procesit dhe të dokumentit, të shoqëruar edhe me raportin e VSM-se.

9.1.1 Vizioni për të ardhmen e Komunës së Rahovecit, (PZHK Rahovecit 2018-2026)

Vizioni për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Rahovecit shprehë qëllimet afatgjata të synuara për tu arritur, të përcaktuara përmes procesit pjesëmarrës të palëve të interesit dhe analizave shumë-sektoriale, duke u nisur nga gjendja aktuale, sfidat e identifikuar, nevojat për zhvillim, si dhe potencialet lokale.

Gjatë përshkrimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese – profilin komunal, janë grumbulluar dhe analizuar të dhëna të shumta për fusha të ndryshme. Në bazë të këtij vlerësimi janë identifikuar edhe sfidat kryesore të komunës.

Faza e dytë e planit parasheh zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve hapësinore me të cilat përballlet komuna e Rahovecit.

Vizioni, parimet dhe caqet, përfshijnë parashikimet e favorshme të zhvillimeve të ardhme në fusha të ndryshme si:

- Ekonomike
- Infrastruktura teknike
- Infrastruktura e transportit
- infrastruktura publike dhe sociale
- Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri
- Asetet e trashëgimisë natyrore
- Vendbanimet
- Banimi
- Vendbanimet joformale
- Shfrytëzimi i tokës

Komponentat këto sipas udhezimit administrative për PZHK dhe programit të hartimit të PZHK të komunes së Rahovecit

Përmes kësaj deklarate prezantohet zhvillimi i ardhshëm i komunës në formë të përmbledhur si në vijim:

Rahoveci komune lidere në mbrojtje të trashëgimisë kulturore e natyrore si dhe zhvillim të hovshëm në bujqësi, ndërmarrësi dhe arsim,.

Përmes këtij vizioni, njëkohësisht ofrohen zgjidhje për sfidat e identifikuar në fazën e parë.

Vizioni për Komunën e Rahovecit parasheh zhvillime konkrete dhe të realizueshme si:

- Zhvillim të hovshëm në gjith sektorët e bujqësisë
- Avancim të administratës publike
- Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë
- Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi
- Zhvillim të vendbanimeve dhe ndertime me plan
- Mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore
- Ekonomi të zhvilluar
- Infrastrukturë e planifikuar bashkëkohore

9.1.2 Qëllimet dhe objektivat zhvillimore

Përcaktimi i qëllimeve për fusha përkatëse paraqet hapin e mëtejshëm dhe më specifik drejt arritjes së vizionit, gjithmonë duke i pasur parasysh çështjet e identifikuar, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet mundshme në dispozicion.

Për secilin qëllim janë përcaktuar edhe objektivat përkatëse, si elemente më specifike, të matshme dhe të arritshme, në mënyrë që të jepet një kornizë më konkrete për zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit.

Objektivat e Përgjithshme	Objektivat specifike
Përmirësimi i mirëqenies sociale	✓ Zhvillimi i aftësive për punësim, me fokusim te femrat dhe të rinjtë ✓ Zhvillimi i programeve për punësim, ✓ Sigurimi i punës sezonale ✓ Zhvillimi i skemave të përkrahjes financiare dhe sociale për kategoritë në nevojë, ✓ Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme
Përmirësimi i nivelit të shërbimeve shëndetësore	✓ Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shërbimet shëndetësore ✓ Përmirësimi i infrastrukturës teknike në objektet shëndetësore ✓ Krijimi i kushteve për edukim të vazhduar të personelit profesional në shëndetësi
Përmirësimi i nivelit të arsimit	✓ Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimin e shkollave të reja. ✓ Nga shtatori I viti 2018-2019 do të bëhet funksionalizimi i plotë dhe i përhershëm i organeve drejtuese të shkollave dhe këshillave drejtues të shkollave. ✓ Ofrimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike, dhe trajnimeve profesionale të

	✓ mësimdhënësve. ✓ Sigurimi i edukimit parashkollor , sipas nevojave të identifikuar ✓ Sigurimi i qasjes në arsim për të gjitha moshat shkollore ✓ Kompletimi i infrastrukturës shkollore , sipas nevojave të identifikuar
Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndërtesave të kulturës	✓ Funksionalizimi i ndërtesave ekzistuese të kulturës ✓ Shfrytëzimi kontinual i ndërtesave të kulturës ✓ Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese në zonat rurale për zhvillimin e ngjarjeve kulturore – shkollat, hapësirat publike
Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion	✓ Funksionalizimi i objekteve ekzistuese sportive ✓ Shfrytëzimi kontinual i objekteve sportive
Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike	✓ Përmirësimi i hapësirave ekzistuese publike ✓ Krijimi i hapësirave të reja publike ✓ Mirmbajtja e hapësirave publike
Ofrimi i banimit të qëndrueshëm	✓ Ofrimi zgjidhjeve të qëndrueshme të banimit për familjet në nevojë
Rritja e densitetit në qendrën komunale	✓ Konsolidimi i lagjeve të qendrës komunale ✓ Konsolidimi i qendrës dhe përmbytjeve shumëfunksionale
Zhvillimi i vendbanimeve në mënyrë kompakte	✓ Konsolidimi i lagjeve të vendbanimeve duke e ruajtur karakterin ✓ Lidhje funksionale me qendrën urbane ✓ Formimi i qendrave të reja sekondare ✓ Zgjidhje për ndërtimet ilegale dhe vendbanimeve joformale
Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, vreshtarise dhe kapaciteteve përpunuese	✓ Konsolidimi dhe rritja e kapaciteteve bujqësore ✓ Zhvillimi i bujqësisë dhe prodhimeve bujqësore ✓ Stimulimi i pemëtarisë ✓ Zhvillimi i prodhimtarisë vreshtare dhe plasim i sigurtë në tregun Evropian dhe më gjërë
Zhvillimi i kapaciteteve turistike	✓ Shfrytëzimi i qëndrueshëm i potencialeve natyrore dhe kulturore ✓ Zhvillimi i turizmit rural, ✓ Zhvillimi i kapaciteteve shërbyese dhe hoteliere, ✓ Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore,
Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe industrisë së lehtë	✓ Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas kërkesave në tregun vendor dhe regjional ✓ Bashkëpunimi ndër-sektorial në nivel komunal dhe ndër-komunal
Zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës së mobilitetit	✓ Përmirësimi i qarkullimit në qendrën komunale ✓ Kompletimi i rrjetit i rrjetit rrugor në zonat rurale ✓ Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët ✓ Rritja e shfrytëzimit të transportit publik ✓ Sigurimi i kushteve për qarkullim jo-motorik ✓ Përmirësimi i sigurisë së qarkullimit
Menaxhimi adekuat me ujëra	✓ Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit për nevojat e banimit dhe të zhvillimit ✓ Ofrimi i sistemeve funksionale te ujësjellësit për të gjitha vendbanimet ✓ Ofrimi i sistemeve funksionale te kanalizimit për të gjitha vendbanimet ✓ Trajtimi i ujërave të zeza ✓ Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e ujërave atmosferik
Menaxhim adekuat i mbeturinave	✓ Parandalimi dhe largimi i mbeturinave ne trupat ujqor dhe mjedise tjera si deponi ilegale ✓ Mbulimi i të gjitha vendbanimeve me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave
Mbrojtja e mjedisit	✓ Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale ne Lumenj si dhe ✓ Ndërtimi i impiantit për trajtim te ujërave të zeza ✓ Reduktimi i ndotjes së ajrit ✓ Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i tokës bujqësore ✓ Mbrojtja e pyjeve dhe rryllëzimi ✓ Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve ✓ Shfrytëzimi racional i zhavorrit dhe gurthyesve për një

	✓	zhvillim të qëndrueshëm Zvogëlimi i impakteve negative nga kafshë
Mbrojtja nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera	✓ ✓	Mbrojtja nga zjarret Reduktimi i zonave të rrezikuara nga vërshimet
Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, natyrore	✓ ✓ ✓	Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore Promovimi i vlerave të trashëgimisë lokale

Nga parimet strategjike të hapësirës dhe zbatimit, formojmë një bazë të qëndrueshme për vendimmarrje të mëtijshme dhe të qëndrueshme gjatë periudhës së zbatimit të planit zhvillimor (PZHK Rahoveci 2018 – 2025).

Kapitulli i kornizës hapësinore përfshinë të gjitha elementet si në vijim:

9.1.3 Koncepti i Zhvillimit Hapësinor

- Avancim të administratës publike
- Krijimi i parqeve të reja dhe hapësirave për parking
- Zhvillimi i bujqësisë
- Zhvillimi i prodhimit vreshtarë dhe plasim i sigurtë në tregun Evropian dhe më gjërë
- Mbrojtje e mjedisit dhe shfrytëzim racional
- Planifikimi i 3 kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza
- Infrastruktura e planifikuar bashkëkohore si në zonën urbane ashtu edhe në zonat rurale.
- Zhvillim të vendbanimeve, trajtim të vendbanimeve joformale si dhe ndertimeve me plan
- Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi,
- Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë
- Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore

9.2 Koncepti i Zhvillimit Hapësinor

Korniza e kapitullit hapësinor zgjedh për skenar të zhvillimit të metutjeshëm:


Skenarin e zhvillimeve policentrike si modeli më i përshtatshëm për Rahovecin (krahasuar me skenarët monocentrike dhe lineare). Zhvillimi policentrik synon në shpërndarjen e aktiviteteve në kuadër të vendbanimit apo disa vendbanimeve, ndërtimin, rehabilitimin dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, qasjes në transport, qasje më të mirë në shërbimet sociale dhe krijimin e kushteve më të favorshme për punë dhe rekreacion në të gjitha lokalitetet.

Gjithashtu synon të adresoj zhvillimet e ndaluara në vendbanimet malore përmes sigurimit të infrastrukturës themelore dhe përdorimit të burimeve lokale për zhvillimin e mëtejshëm. Kjo qasje aktualisht është e shpërndarë gjerësisht dhe është në përputhje me Perspektivën Evropiane për Zhvillim Hapësinor (ESDP)³.

Kjo gjë do të duhej të ndihmonte në gjetjen e bilancit në mes të zonave rurale dhe urbane dhe të sigurojë kushte në mënyrë që zonat rurale të asimilojnë me sukses ndryshimet strukturore.

³ http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docoffic/official/reports/pdf/sum_en.pdf

Keshtu skenari e percakton ndarjen-organizimin e ardhshem te komunes ne nje zone Qendrore urbane (Rahoveci) si dhe 6 zona Sub-Urbane (Ofterushe, Krush e Madhe, Xërxë, Ratkoc, Drenoc dhe Çifllak).



Korniza e ndanë zonën e Rahovecit në dy nën-regjione; a) zona jug-perëndimore (kopshtet) b) zona veri-lindore (kodrat dhe natyra) sepse ka shumë dallime sa i përket morfologjisë së terrenit dhe faktorëve natyror, por gjithashtu sa i përket faktorëve ekonomik, social, mjedisor, infrastrukturor dhe shërbimeve.

Bazuar në parashikimet e popullsisë shkalla e zgjerimit të vendbanimeve janë të hartuara për secilin vendbanim. Zgjerimi i vendbanimeve në kufi të zonës së propozuar minimizon konfliktet në mes të vijës së ndërtimit dhe bujqësisë. Me këtë propozim janë përmbushur mangësitë e tokës brenda vendbanimeve

Në fund faza e implementimit propozon strategjinë e zhvillimit të komunës ku qëllimet strategjike janë të shpjeguara më tej dhe një gamë e gjerë e zbatimeve të projekteve janë të listuara në mënyrë që të arrihet qëllimi strategjik. Për çdo projekt afati kohor paraprak, autoriteti përgjegjës dhe perspektiva financiare (shkalla e koston dhe burimi) janë të përcaktuara. Kjo fazë gjithashtu ka një dimension hapësinor duke siguruar lokacione për zhvillimin e ardhshëm ekonomik (siç është industria, tregtia, turizmi etj). Te gjitha keto te paraqitura ne Skenarin e Zhvillimit te metutjeshëm te Komunes së Rahovecit.




Figura 3. Skenari i zhvillimit (PZHK-ja)

Faza finale e PZHK-së përbehet nga dispozitat e implementimit – dispozitat e përgjithshme, palët përgjegjëse, kushtet për përcaktimin e destinacioneve të sipërfaqeve, kushtet për organizimin hapësinor, zhvillimin e vendbanimeve, zhvillimin social dhe administrimin efektiv dhe masat parandaluese ndaj ndikimeve të dëmshme në mjedis.

10.ZHVILLIMI EKONOMIK SIPAS SEKTORËVE

10.1.1 Bujqësia

10.1.2 Industria

10.1.3 Ndërmarrjet dhe biznesi

10.1.4 Potencialet turistike

10.1.5 Qasja

10.1.6 Pejsazhi

10.1.7 Turizmi

10.1.8 Zhvillimi social

10.1.9 Arsimi

10.1.10 Shëndetësia

10.1.11 Kultura

10.2 Infrastruktura e transportit

10.2.1 Transporti publik

10.2.2 Infrastruktura teknike

10.2.3 Menaxhimi i ujërave

10.3 Furnizimi me ujë i qytetit

10.4 Menaxhimi i mbeturinave

10.5 Furnizimi me energji

10.6 Mjedisi dhe trashëgimia natyrore

11.ANALIZA E PLOTË E NDIKIMIT NË MJEDIS TË PZHK-SË SIPAS VSM

11.1 Masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit

12.MONITORIMI

13.VSM - SUGJERON DISA VEPRIME OPERACIONALE KONKRETE

14.PËRFUNDIME

15.REFERENCE- LITERATURA

•

DRAFT